



Albania  
Investment  
Council

Improving Transparency and Investment Climate

# SFIDAT E NVM-ve<sup>1</sup> NË KALIMIN DREJT BURIMEVE ALTERNATIVE TË ENERGJISË

Tiranë, Janar 2023

<sup>1</sup> NVM-të sipas ligjit 43/2022 "Për Zhvillimin e Ndërmarrjeve Mikro, të Vogla dhe të Mesme", janë tërësia e ndërmarrjeve në të cilat punësohen më pak se 250 persona dhe realizojnë një shifër afarizmi ose një bilanc total vjetor jo më të madh se 250 milionë lekë.

**K**y dokument pune është përgatitur në kuadër të Mbledhjes XXIX të Këshillit të Investimeve (31 janar 2023) nga Sekretariati i Këshillit të Investimeve.

Analiza vjen si rezultat i një bashkëpunimi të ngushtë të ekspertëve të brendshëm të Sekretariatit, z. Elvis Zerva, Ekspert Ligjor dhe Rregullator, znj. Elida Fara, Eksperte Ekonomike, znj. Xaira Shurdha, Eksperte Monitorimi dhe Ndërlidhjes dhe ekspertëve të jashtëm, z. Sokol Spahiu, z. Ledjon Shahini, dhe z. Martin Serreqi, të cilët kanë kontribuar në mënyrë esenciale me ekspertizën e tyre në aspektet teknike të analizës dhe shtyllat e saj. Puna e përgjithshme në ekip u drejtua nga Drejtorja e Sekretariatit, znj. Diana Leka (Angoni) dhe u përfitua nga mbështetja e znj. Elisa Lula, Oficere Administrative dhe Komunikimit në Sekretariat, në redaktimin gjuhësor të materialit.

Falenderojmë për kontributin në organizimin e intervistave të drejtpërdrejta dhe mbledhjeve fokus grupe me kompanitë private, shoqatat e biznesit dhe dhomat e tregtisë (Auleda Vlorë, DHTI Durrës, Unionin e Prodhuesve Shqiptarë, Dhomen Ekonomike të Gruas) dhe Bashkinë e Korçës, si dhe edhe institucionet publike (Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë për Eficiencën e Energjisë), për kontributin e tyre gjatë përgatitjes së këtij materiali.

## LISTA E SHKURTIMEVE

<b>ALPEX</b>	Bursa e Energjisë
<b>AZHBR</b>	Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural
<b>VKM</b>	Vendim i Këshillit të Ministrave
<b>OSSH</b>	Operatori i Sistemit të Shpërndarjes
<b>KESH</b>	Korporata Elektroenergjitike Shqiptare
<b>BERZH</b>	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
<b>KE</b>	Komisioni Evropian
<b>ERE</b>	Enti Rregullator i Energjisë
<b>PRE</b>	Programi i Reformave Ekonomike
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>INSTAT</b>	Instituti i Statistikave
<b>PKVBR</b>	Plani i Konsoliduar Kombëtar i Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë
<b>PKE</b>	Strategjia Kombëtar e Energjisë 2018 - 2030
<b>NVM</b>	Ndërmarrje e Vogël dhe e Mesme
<b>MIE</b>	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
<b>MFE</b>	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
<b>BP</b>	Ballkani Perëndimor

## PËRMBAJTJA

<b>HYRJE</b> .....	<b>5</b>
<b>METODOLOGJIA</b> .....	<b>7</b>
<b>KONTEKSTI</b> .....	<b>9</b>
<b>ZHVILLIMET NË SEKTOR</b> .....	<b>16</b>
<b>GJETJE DHE ANALIZA</b> .....	<b>18</b>
<b>REKOMANDIME</b> .....	<b>30</b>
<b>BIBLIOGRAFIA</b> .....	<b>35</b>
<b>ANEKSI I</b> .....	<b>37</b>
<b>ANEKSI II</b> .....	<b>38</b>
<b>ANEKSI III</b> .....	<b>45</b>
<b>ANEKSI IV</b> .....	<b>47</b>
<b>ANEKSI V</b> .....	<b>53</b>

# HYRJE

**S** hqipëria mund të kthehet në një “bateri të gjelbër”<sup>2</sup> për rajonin e Ballkanit për shkak të potencialit të saj të jashtëzakonshëm në burimet e rinovueshme. Megjithatë, për shkak të ndryshimeve në gjendjen hidrike dhe mungesës së diversifikimit të burimeve, vendi është mjaft i ekspozuar ndaj rrezikut të pasigurisë së furnizimit me energji elektrike në mënyrë të vazhdueshme. Duke iu referuar Strategjisë Kombëtare të Energjisë 2030<sup>3</sup> “qeveria është angazhuar për zbatimin e një politike të rritjes së përdorimit të energjisë së rinovueshme, kryesisht hidro, diellore dhe erës, si një perspektivë afatgjatë e nevojshme për të mbështetur zhvillimin e përgjithshëm ekonomik, sigurinë e furnizimit me energji dhe mbrojtjen e mjedisit”. Pavarësisht disa ndërhyrjeve të qeverisë, Raporti i fundit i Progresit të BE-së 2022 thekson se: “Ka pasur përparim të kufizuar në reformën e tregut të energjisë

elektrike dhe masat e ndërlidhjes përsa i përket burimeve të rinovueshme dhe gazit dhe linjave rajonale të interkonjeksionit, si edhe diversifikimit të prodhimit të energjisë nga hidrocentralet drejt prodhimit nga burime të tjera<sup>4</sup>”.

Në një kontekst rajonal, në vijim edhe të Deklaratës së Sofjes (2019) dhe një sërë angazhimesh politike dhe instrumentesh të politikës së gjelbër të BE-së, *vendet e Ballkanit Perëndimor*<sup>5</sup> janë përfshirë në reforma mbi krijimin e tregjeve konkurruese dhe të integruara të energjisë për t’iu përshtatur një mjedisi të ri rregullator (si p.sh. përcaktimi i objektivave detyrues ligjorë me afate dhe rrugëtime të përcaktuarara, ndërkohë që duhet të sigurojnë edhe kapacitet dhe funksionimin e mekanizmave financiare dhe rregullatore të nevojshme për zbatimin e tyre) si pjesë e Axhendës së Gjelbër.

4 Faqe 104, Progres Raporti 2022

5 Përsa i përket ekonomive të Ballkanit Perëndimor ato po përballen me dy sfida kryesore. Së pari, duhet të përmbushin detyrimet ekzistuese të kahershme si krijimi i tregjeve konkurruese dhe të integruar të energjisë në përputhje me rregulloret e fundit. Së dyti, zbatimi i reformave do të bëhet gjithnjë e më i vështirë në një mjedis rregullator që ndryshon dinamikisht.

2 <https://www.euractiv.com/section/energy-environment/news/eib-albania-must-push-reform-green-transition-to-improve-citizens-lives/>

3 Miratuar me VKM Nr.480, datë 31.7.2018; Gjithashtu duhet të inkurajohet përmirësimi i përdorimit të Skemes së Menaxhimit dhe Auditimit Eko të BE-së (EMAS).

Ndërkohë komuniteti i biznesit në vend duhet të nxitet drejt marrjes në konsideratë të modeleve të reja të të bërit biznes, të cilat përfshijnë edhe sipërmarrjen e gjelbër, dizenjimin e produkteve qarkulluese, investime të qëndrueshm<sup>6</sup>, si edhe të jetë i përgatitur të përqafojë politikën e produktit të qëndrueshëm dhe përgjegjësinë e zgjeruar të prodhuesit si edhe të parandalojë prodhimin e produkteve të dëmshme për mjedisin (nëse parashikojnë tregun e BP). *Mungesa e mbështetjes dhe stimujve specifikë drejt tranzicionit të gjelbër mund të pengojë realizimin e tij, duke marrë parasysh edhe ndikimin e krizës pas Covid-19 në veprimtarinë e biznesit, veçanërisht tek NVM-të.*

Për t'iu përgjigjur shqetësimeve të biznesit vendas, ky studim fillimisht u mbështet në çështjet sistematike të raportuara nga komuniteti i biznesit (kompanitë, dhomat e tregtisë dhe shoqatat e biznesit) në lidhje me sektorin e energjisë dhe të ruajtura në bazën e të dhënave të Sekretariatit “Mbi Çështje të Klimës së Investimeve, 2015-2021”. Disa nga këto çështje kanë të bëjnë me tema të tilla si (a) modeli i tregut të energjisë dhe bursa e energjisë; (b) furnizimi

6 Investim i qëndrueshëm nënkupton një investim në një aktivitet ekonomik që kontribuon në: Një objektiv mjedisor, i matur, për shembull, nga treguesit kryesorë të efikasitetit të burimeve për përdorimin e energjisë, energjisë së rinovueshme, lëndëve të para, ujit dhe tokës, prodhimi i mbetjeve, dhe emetimet e gazeve serrë, ose në ndikimin e tij në biodiversitet dhe ekonominë rrethore, ose një investim në një aktivitet ekonomik që kontribuon në një objektiv social, në veçanti një investim që kontribuon në trajtimin e pabarazisë ose që nxit kohezionin social, integrimin social dhe marrëdhëniet e punës, ose një investim në kapitalin njerëzor ose në komunitetet të pafavorizuara ekonomikisht ose shoqërore, me kusht që investime të tilla të mos dëmtojnë ndjeshëm asnjë nga këto objektiva. Dhe që kompanitë e investuara të ndjekin praktikën e mira të qeverisjes, veçanërisht në lidhje me strukturat e shëndosha të menaxhimit, marrëdhëniet me punonjësit, shpërblimin e stafit dhe pajtueshmërinë me taksat. Burimi: Rregullorja e BE 2019/2088 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 27 nëntor 2019 “Mbi qëndrueshmërinë në sektorin e shërbimeve financiare.

me energji dhe cilësia e furnizimit; (c) skema e netimit për vetë-prodhuesit/fotovoltaikët nën 2 MW; (d) praktikën më të mira të stimulimit të burimeve të rinovueshme. Gjithashtu, u morën në konsideratë edhe shqetësime të tjera si instrumentet aktuale zbatuese/apeluese në rast të ndërprerjes së energjisë, statusi i qartësimit të procedurave të faturimit për përdorimin e burimeve alternative, ndërgjegjësimi i biznesit mbi informacionin për produktet e reja bankare, aplikimi i taksave vendore bashkiake për procedurat e ndërtimit fotovoltaik, pritshmëritë e biznesit për stimuj si përjashtime nga TVSH-ja apo taksat të tjera vendore, paqartësi në lidhje me periudhën e kthimit të investimit, etj.

*Gjetjet në këtë dokument pune synojnë të sjellin në tryezën e Këshillit të Investimeve, perspektivën e biznesit (me fokus NVM-të) dhe qasjen për të zbutur kostot që lidhen me pasiguritë e investimeve në diversifikimin e burimeve të energjisë. Për të përfituar nga momenti, dokumenti gjithashtu përmbledh temat për një diskutim më të gjerë. Qëllimi është që të ushqehet/përafrohet debati bazuar në të dhëna gjithëpërfshirëse, fakte dhe perspektivë praktike dhe të gjenerohen opsione konstruktive për adresimin e pasigurive të sipërmarrësve në kuadër të agjendës së gjelbër.*

Në funksion të debatit, dokumenti ofron gjithashtu një përditësim mbi detajet e licencimit drejt burimeve alternative, lidhjen e konsumatorëve në rrjetin e tregut të energjisë elektrike me fokus NVM-të, një pasqyrë e shkurtër e tregut të energjisë elektrike (ALPEX) dhe zhvillimeve kryesore të tij, një ushtrim krahasues për periudhën e kthimit të investimit dhe një përshkrim të instrumenteve aktuale financiare dhe programet e partnerëve për zhvillim në fushën e energjisë në dispozicion të biznesit.

## METODOLOGJIA

Analiza bazohet në një metodologji gjithëpërfshirëse e cila konsiston në:

- Desk Research* - Konsultimi i dokumenteve, ligjeve dhe akteve nënligjore, raporteve kombëtare dhe ndërkombëtare për Energjinë në Shqipëri dhe burimeve zyrtare mbi investimet strategjike, përfshirë ato në sektorin e energjisë<sup>7</sup>.
- Sinteza e gjetjeve dhe rekomandimeve* të paraqitura në raportet kombëtare dhe ndërkombëtare nga aktorë të ndryshëm në lidhje me sektorin e energjisë, me fokus Energjinë e Rinovueshme dhe Eficiencën e Energjisë.
- Model interviste e strukturuar* iu dërgua online 23 kompanive të përzgjedhura që operojnë në fushën e akomodimit/hoteleve, industrisë përpunuese, shërbimeve ushqimore, dhe ndërtimit. Objektivi kryesor i pyetësorit ishte të eksploronte sfidat me të cilat përballen kompanitë për sa i përket kostos dhe cilësisë së investimeve në eficiencën e energjisë dhe/ose panelet diellore.

7 <https://www.aida.gov.al/sq/investimet-strategjike/komiteti-investimeve-strategjike/vendimet-e-komitetit-te-investimeve-strategjike>

- Pyetësor* – një anketë e strukturuar u dërgua online në databazën e kompanive që Sekretariati disponon dhe u morën gjithsej 75 përgjigje anonime. Objektivi i sondazhit ishte eksplorimi i njohurive të biznesit mbi mundësitë drejt investimit në eficiencën e energjisë dhe/ose burimet alternative të prodhimit të energjisë dhe njohja e tyre me burimet e financimit të investimeve.
- 16 takime konsultative* me biznese individuale u realizuan gjatë periudhës dhjetor 2022 – janar 2023 në Vlorë, Korçë dhe Tiranë.
- Organizimi i 4 Fokus Grupeve* (47 pjesëmarrës) me shoqata të biznesit dhe dhoma të tregtisë, ekspertë, institucione të përzgjedhura në nivel teknik dhe politik, OJQ, partnerë për zhvillim, akademi, etj.

Për qëllime të këtij dokumenti pune, janë evidencuar çështje konkrete pas një komunikimi mjaft ndërveprues me bizneset e sektorëve të përzgjedhur, përkatësisht: akomodim/hoteleri, industri përpunuese, shërbim ushqimor, ndërtim, etj. Për të marrë një mostër më përfaqësues, subjektet e kontaktuar kanë qenë të lidhura në të gjitha nivelet e tensionit që

korrespondojnë me një NVM, konkretisht 0.4 kV, 6 kV, 10 kV, 20 kV dhe 35 kV. Këto nivele të tensionit përfshijnë subjektet e furnizuara nga Furnizuesi i Shërbimit Universal me tarifata e miratuara nga ERE (0.4 kV), subjektet e furnizuara nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit me tarifata e miratuara nga ERE (6 kV, 10 kV dhe 20 kV) dhe subjektet e furnizuara nga subjekte alternative (tregu i derregulluar) me çmime të negociuara lirisht (35 kV).

Dëshirojmë të falenderojmë për bashkëpunimin dhe mbështetjen e tyre Dhomen e Tregtisë Durrës, Auleda Vlorë, Unioni i Prodhuesve

Shqiptarë, Dhoma Ekonomike e Gruas dhe përfaqësues të tjerë të biznesit nga Korça dhe Vlora. Një falenderim i veçantë edhe institucioneve publike si AZHBR, Bashkia Korçë, MIE dhe Ambasada Zvicereane në Tiranë për dhënien e informacionit përkatës. Për të marrë një rezultat më përfaqësues, janë zhvilluar takime edhe me subjekte që kanë investuar në ndërtimin e paneleve diellore (si prodhues), subjekte që kishin informacion por prisnin përmirësime ligjore si dhe subjekte që ishin të interesuara për të investuar por nuk kishin informacion të mjaftueshëm.


## KONTEKSTI

### 1. PSE FURNIZIMI ME ENERGJI ËSHTË "KRITIK" PËR EKONOMINË, VEÇANËRISHT PËR NVM-TË

Furnizimi me energji elektrike në Shqipëri është pothuajse tërësisht i varur nga hidrocentralet, 98% e prodhimit të energjisë elektrike vjen nga hidrocentralet, *duke e bërë atë tërësisht të varur nga kushtet e motit dhe nga regjimi hidrik i lumenjve dhe burimeve*. Shqipëria priret të orientohet drejt importit të energjisë, kryesisht gjatë periudhës së verës. Ky është një tregues i varësisë së këtij sistemi nga një

regjim hidrologjik i paqëndrueshëm. Sistemi i furnizimit të sektorit të energjisë elektrike në Shqipëri e bën atë shumë të çënueshëm ndaj ndryshimeve klimatike, veçanërisht në kuadër të ndryshimeve klimatike që ndodhin në Ballkanin Perëndimor. Luhatja e madhe e prodhimit të hidrocentraleve çon vazhdimisht në nevojën për import të energjisë elektrike duke e bërë Shqipërinë një importuese neto të energjisë. *Në dritën e krizave të fundit energjetike, çënueshmëria e sistemit energjetik në vend është një "kërcënim" i drejtpërdrejt për kostot e biznesit, në veçanti për NVM-të.*

Figura 1. Prodhimi dhe importi i energjisë 2000-2021 (MWh)



Burimi: INSTAT

## 2. TREGU I ENERGJISË ELEKTRIKE – NEVOJA PËR DIVERSIFIKIM TË BURIMEVE

Prodhimi i energjisë elektrike në Shqipëri prodhohet nga KESH, korporata publike e prodhimit, si dhe nga subjekte të tjera si prodhuesit prioritarë, prodhuesit e pavarur dhe vetëprodhuesit e energjisë elektrike. Kapaciteti total i instaluar i termocentraleve të lidhur me rrjetin e shpërndarjes është rritur gjatë viteve të fundit për shkak të investimeve të reja private në hidrocentrale dhe së fundmi në impiante të vogla fotovoltaike. Në vitin 2021, kapaciteti total i prodhimit të energjisë elektrike të instaluar në vendin tonë ishte 2,605 MW, nga të cilat 1,448 MW janë pronë shtetërore (1,350 MW hidro dhe 98 MW termike), ndërsa pjesa tjetër është private. Sipas të dhënave, kapaciteti prodhues i vitit 2021 ka pasur një rritje prej 97 MW, krahasuar me vitin 2020.

*Prodhimi<sup>8</sup> i energjisë elektrike i impianteve të lidhura në rrjetin e shpërndarjes në vitin 2021 ishte 905,230 MWh, ndërsa prodhimi i impianteve të lidhura me*

**Figura 2. Të dhëna mbi prodhuesit e energjisë 2021**

Prodhuesit e energjisë <sup>2</sup>	Kapaciteti instaluar (MW)	Prodhimi 2021 (MWh)
Prodhues Publik	1,448	5,343,974
Prodhues të Pavarur (Prodhues në treg të Hapur)	436	1,425,989
Prodhues me Përparësi (Përfitojnë nga Skemat Mbështetëse) +Ashta	380	1,246,750
Prodhues me Përparësi (Përfitojnë nga Skemat Mbështetëse)	318	905,230
Prodhues me Përparësi Fotovoltaikë (Përfitojnë nga Skemat Mbështetëse)	23	40,756

*Burimi: ERE*

<sup>8</sup> Kapaciteti total i instaluar në termocentralet në rrjetin e transmetimit është 2,264 MW. Prodhimi neto i energjisë elektrike të prodhuar nga hidrocentralet e lidhur me rrjetin e transmetimit në vitin 2021 ishte 8,016,730 MWh. Kapaciteti total i instaluar i termocentraleve në rrjetin e shpërndarjes është 341 MW, nga të cilat 318 MW fuqi është e instaluar në burimet Hidrocentrale dhe 23 MW fuqi e instaluar janë impiante fotovoltaike.


*impiantet fotovoltaike arriti në 40,756 MWh. Deri në vitin 2017, Shqipëria ofronte vetëm stimuj për energjinë e rinovueshme për hidrocentralet. Megjithatë, legjislacioni i miratuar në vitin 2017 promovoi prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme. Përkundër kësaj, deri në vitin 2022 energjia diellore dhe e erës mbeti e pazhvilluar, megjithëse janë ndërmarrë disa investime të vogla në zhvillimin e energjisë diellore me një kapacitet prodhimi diellor prej vetëm 23 MW me një kapacitet të instaluar prej 2 MW. Aprovimi paraprak është dhënë edhe për disa ferma me erë. Plani Kombëtar i Veprimit për Energjinë e Rinovueshme nxit investimet në zhvillimin e parqeve të erës në shkallë të vogël më pak se 3 MW për një kapacitet total të instaluar prej 30 MW. Potenciali i erës si burim energjie është i shpërndarë në të gjithë territorin, me një shpejtësi mesatare vjetore të erës ndërmjet 6-8 m/s<sup>9</sup>.*

*Për sa i përket efikasitetit të energjisë elektrike, në Shqipëri ka një potencial të konsiderueshëm për t'u rritur, veçanërisht lidhur me humbjet e në sistemin e shpërndarjes, të cilat arrijnë në 20*

<sup>9</sup> Në Shqipëri ekziston një termocentral me naftë me kapacitet 98 MW, që përfaqëson 4% të kapacitetit total të instaluar, i cili nuk është përdorur që nga ndërtimi i tij në 2011.

*për qind në vitin 2021. Investimi në përmirësimin e termoizolimit të shtëpive dhe përdorimin e pajisjeve që çojnë në reduktimin e energjisë së harxhuar do të ndihmojnë në uljen e kërkesës së panevojshme.*

**Figura 3. Raporti i humbjeve në rrjet kundrejt prodhimit neto (në %)**



*Burimi: INSTAT*

Gjatë gjithë vitit 2021, ka pasur një rritje të impianteve të reja, e cila ka sjellë për pasojë një rritje të prodhimit. Në total, gjatë kësaj periudhe, janë futur në gjenerim 18 termocentrale me fuqi të instaluar 97 MW të cilat gjeneruan sasinë prej 79,971 MWh gjatë vitit 2021. Ky prodhim i ri i energjisë elektrike i prodhuar nga impiantet e reja që llyjnë në prodhim gjatë vitit 2021, zë rreth 0.9% të totalit të prodhimit vendas të energjisë elektrike për këtë vit.

## Tregu i energjisë elektrike (ALPEX)

Tregu i energjisë elektrike karakterizohet aktualisht vetëm nga kontrata bilaterale, lidhura ndërmjet shoqërive që operojnë në tregun shqiptar të energjisë elektrike. Themelimi i tregut të organizuar (Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX) është në procedurat finale. Është përzg-

jedhur shoqëria e cila do të ofrojë platformën e zhvillimit të transaksioneve si dhe janë hartuar rregullat për funksionimin e ALPEX. Në tremujorin e parë të vitit 2023 parashikohet që të zhvillohen trajnime me të gjithë pjesëtarët e tregut të energjisë elektrike, miratohen aktet bazë për funksionimin e ALPEX si dhe të fillojë procedura e testimit (dry run). Në përfundim të procedurës së testimit, parashikohet që të themelohet tregu i organizuar i ditës në avancë dhe i brenda të njëjtës ditë.

Me fillimin e tregut të organizuar, do të mundësohet zhvillimi i tregut të energjisë elektrike në një mjedis konkurrues, në tregjet me shumicë si dhe ato me pakicë. Modeli i tregut, me pikë kulminante tregun e organizuar, do të sigurojë përfitime të qenësishme për konsumatorët në drejtim të sigurimit të furnizimit me energji elektrike dhe drejt një shërbimi cilësor - shfrytëzimin më efikas të tregtimit ndërkufitar, duke lejuar përfitimin e sektorit energjistik në drejtim të përdorimit me efikasitet të burimeve gjeneruese - krijimin e kushteve për zhvillimin e një tregu transparent dhe jodiskriminues - liberalizimin e tregut të energjisë elektrike, duke krijuar një strukturë tregu që rrit interesin e numrin e pjesëmarrësve, krijon kushtet për hapjen e sektorit drejt konkurrencës dhe rrit pjesëmarrjen e investitorëve të huaj. Me zhvillimin e tregut të organizuar, konsumatorët e energjisë elektrike do të kenë akses të drejtpërdrejt (konsumatorët e mëdhenj) ose indirekt (nëpërmjet furnizuesve të energjisë elektrike), në ALPEX. Gjithashtu, do të kenë mundësi që të kenë akses në energji elektrike me


bazë orare, dhe, në të ardhmen e afërt, me bazë 15 minutëshe, duke personalizuar furnizimin me energji elektrike me profil të individualizuar.

Me konsolidimin e tregut të organizuar, do të shtohet interesi dhe konkurrenca në sektorin e furnizimit me energji elektrike, duke mundësuar prezantimin e “agreguesve” të energjisë elektrike si dhe zhvillimin e komuniteteve të energjisë elektrike. Këto dy pritshmëri do të mundësojnë tregtimin e energjisë elektrike të prodhuar/konsumuar nga vetëprodhuesit dhe në tregun e energjisë elektrike.

### 3. ROLI I SEKTORIT ENERGETIK NË EKONOMI

Sektori i energjisë luan një rol të rëndësishëm në ekonominë e vendit. Në 2020 kontributi i këtij sektori në ekonomi ishte 2,37% e PBB.

**Figura 4. Kontributi i sektorit të energjisë në PBB, 1996-2020 (%)**



Burimi: INSTAT

Bazuar në të dhënat e INSTAT<sup>10</sup>, sektori me përqindjen më të lartë të përdorimit të energjisë është ai i “Produkteve prej gome dhe plastike, dhe produkte të tjera minerale jo metalike” me 23,1%, vijuar nga sektori i “Shërbimeve të kanalizimeve, trajtimit dhe menaxhimit të mbetjeve” me 17,2%. Gjithashtu sektorë me përdorim të lartë të energjisë në inputet e tyre janë: “Produkte elektronike dhe optike, pajisje elektrike dhe makineri dhe pajisje të paklasifikuara diku tjetër dhe mjete transporti” me 10,2%, “Shërbime financiare dhe të sigurimit” me 8,3% si dhe “Shërbime telekomunikacioni” dhe “Shërbime administrative dhe mbështetëse” me 7,5% secila. Referuar Strategjisë Kombëtare të Sektorit të Energjisë 2030, një analizë e skenarëve të zhvillimit të energjisë zbuloi se, duke pasur parasysh tendencat e rritjes së kaluar dhe sipas një skenari “business-as-usual”, kërkesa vjetore për energji në Shqipëri pritet të rritet me 77% në vitin 2030 krahasuar me nivelet e vitit 2018 (MIE, 2018b). Sektori i transportit parashikohet të vazhdojë të jetë konsumatori më i madh i energjisë gjatë dekadës

10 Tabelat e Burim, Përdorimeve dhe Input-Output, 2019, INSTAT.

së ardhshme, duke kontribuar në vazhdimin e importeve neto të energjisë. Konsumatori i dytë më i madh i energjisë do të jetë sektori rezidencial, i ndjekur nga sektori industrial dhe ai i shërbimeve. Rritja më e lartë e kërkesës për energji do të vërehet në sektorin e shërbimeve.

### 4. TRAJTIMI I PASIGURIVE TË SIPËRMARRËSVE NË LIDHJE ME FORMAT ALTERNATIVE TË BURIMEVE TË ENERGISË – ANALIZA KOSTO-PËRFITIM E INVESTIMEVE NË PANELET FOTOVOLTAIKE (VETË-PRODUESIT)<sup>11</sup>

*Për të analizuar kthimin e investimeve në energjitë e rinovueshme (penele fotovoltaike - vetëprodhuesit), janë marrë në konsideratë supozimet e mëposhtme:*

- » *Kapaciteti: 100 kW, në taracë* (prodhimi i energjisë elektrike është përlogaritur duke konsideruar rrezatimin e mesatarizuar prej 1,400 kWh/kWp, siç përcaktuar në pikën 6, të Udhëzimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 3, datë 20.06.2019 “Për miratimin e procedurës së lehtësuar të autorizimit për lidhjen në sistemin e shpërndarjes të projekteve të

vogla të rinovueshme për vetëprodhuesit e energjisë elektrike nga dielli”);

- » *Investimi fillestar: 7,605,000 lekë (650 Euro/kW, pa TVSH);*
- » *Kosto vjetore O&M: 117,000 lekë;*
- » *Rritja vjetore e kostove O&M: 3%;*
- » *Jetëgjatësia: 25 vite;*
- » *Norma e skontimit (aktualizimit): 5%.*


*Për konsumatorët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, janë konsideruar dy variante:*

- » do të vazhdojnë të furnizohen me çmime/njësi sipas konjunkturave të tregut;
- » do të unifikohen me konsumatorët e lidhur në nivelin 20, 10 & 6 kV lidhur me mbështetjen shtetërore (çmimi/njësi deri në vitin 2024 do të jetë 18.26 lekë/kWh), në vijim, sipas konjunkturave të tregut.

*Konsumatorët e lidhur në nivelin e tensionit 20, 10 & 6 kV do të furnizohen me çmim/njësi 18.26 lekë/kWh deri në vitin 2024, në vijim, sipas konjunkturave të tregut.*

*Konsumatorët e lidhur në nivelin e tensionit 0.4 kV do të furnizohen me çmim/njësi të rregulluar prej 14.00 lekë/kWh.*

**Figura 5. Periudha e kthimit të investimit në energji të rinovueshme NPV e 100 kW PV sipas niveleve të tensionit**



Burimi: Kalkulime të ekspertëve

11 Vetëprodhues i energjisë elektrike, bazuar në ligjin Nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, konsiderohet një shoqëri e vogël ose e mesme, i cili mund të instalojë një kapacitet total deri në 500 kW për prodhimin e energjisë elektrike nga era ose dielli.

Përfitimi më i drejtpërdrejt dhe i matshëm, në kuadrin e efijencës energjetike, lidhet me *zëvendësimin e llambave halogjene dhe inkandeshte me LED, si dhe instalimin e kontrolit të ndriçimit, duke përcaktuar periudhën në të cilën do të mbetet ndezur një dritë. Përveç kësaj, zëvendësimi i bojlerit të vjetër me një boiler të ri kondensues jep një ndikim të menjëhershëm*

## 5. MESAZHE KRYESORE TË RAPORTEVE NDËRKOMBËTARE

### 3.5.1 Raport Progresi i BE për Shqipërinë 2022<sup>12</sup>

Shqipëria ka bërë disa përparime në kuadrin ligjor për efijencën e energjisë (EE), por ende duhet të miratojë të gjitha aktet nënligjore që mungojnë. Nuk janë vendosur mekanizma të rinj financues për efikasitetin e energjisë. Roli, kapacitetet dhe veprimtaria e agjencisë së efijencës së energjisë kanë nevojë për përmirësime të mëtejshme. Shqipëria ka miratuar Planin e saj Kombëtar të Energjisë dhe Klimës 2030, që do të zbatohet në vitin 2022. Rekomandimet e vitit të kaluar nuk janë adresuar plotësisht dhe mbeten të vlefshme<sup>13</sup>.

<sup>12</sup> [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2022\\_en](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2022_en)

<sup>13</sup> Në vitin e ardhshëm Shqipëria duhet veçanërisht: (1) të sigurohet se Bursa e Energjisë (ALPEX) dhe tregu i energjisë elektrike i ditës në vazhdim janë plotësisht funksionalë dhe të vazhdojë forcimi i rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike. (2) kompletimi i ndarjes funksionale të operatorëve të energjisë dhe sigurimi i aksesit të plotë në tregun e liberalizuar për të gjithë klientët në 20 kV në vitin 2022, si dhe zgjerimi progresiv i kësaj aksesit për të gjithë konsumatorët; (3) zbatimin e Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës (NECP) 2020-2030 të përditësuar, duke përfshirë planet e veprimtimit për energjinë e rinovueshme dhe efijencën e energjisë, duke siguruar që të gjitha masat institucionale dhe legislative, si dhe financimi, certifikimi dhe auditimi të jenë në fuqi, duke përfshirë zhvendosjen e burimeve të rinovueshme të prodhimit të energjisë elektrike larg hidrocentraleve, duke marrë parasysh krizën energjetike.

Për sa i përket **energjisë së rinovueshme**, Shqipëria ka miratuar ndryshimet në ligjin e vitit 2017 në janar 2021. Skema mbështetëse e Tarifave Feed-in (FIT) është shndërruar në një kontratë për diferencën (CfD), ndërsa duhet të krijohet një operator i energjisë së rinovueshme (REO). Rregullorja për zbatimin e skemës së mbështetjes CfD dhe REO pritet të jenë në fuqi deri në fund të vitit 2022. Një metodologji çmimi për konsumatorët me një kapacitet të instaluar deri në 500 KW u miratua në vitin 2021 dhe duhet të zbatohet deri në fund të 2022.

*Ende nuk është ngritur agjencia përgjegjëse për energjinë e rinovueshme, detyrë kjo e cila aktualisht zbatohet nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore<sup>14</sup>.*

### 3.5.2 IRENA- Vlerësimi i gatishmërisë për burimet e rinovueshme të Shqipërisë<sup>15</sup> [Mars 2021]

Shqipëria mbetet një importues neto i mallrave dhe shërbimeve. Importet e energjisë në veçanti, kufizojnë ndjeshëm rritjen ekonomike, kanë një efekt negativ në deficitin tregtar të vendit dhe e lënë vendin të hapur ndaj goditjeve të ofertes. Kjo është arsyeja pse, *krijimi i sigurisë energjetike, qëndrueshmëria e sektorit energjetik dhe një furnizim i garantuar me energji me çmime konkurruese janë disa nga sfidat kryesore që vendi duhet të adresojë në afatshkurtër. Këto sfida mund të përmbushen duke rritur më tej pjesën e energjisë së rinovueshme në prodhimin kombëtar të energjisë dhe duke diversifikuar sektorin e energjisë elektrike të vendit.* Ndërsa mundësitë për vendosjen e energjisë diellore janë mjaft të gjera. Insolimi diellor i Shqipërisë është shumë

<sup>14</sup> Faqe 106, Progresi Raporti BE 2022

<sup>15</sup> <https://www.irena.org/publications/2021/March/Renewables-Readiness-Assessment-Albania>

i lartë në pjesën më të madhe të territorit të saj në më shumë se 1500 kWh/m<sup>2</sup> në vit, me kulme prej 1753 kWh/m<sup>2</sup> në vit, veçanërisht në pjesën perëndimore të vendit. Ndërkohë, sipas vlerësimeve të IRENA-s, sipas një skenari kapitali me kosto të ulët, Shqipëria ka një potencial konkurrues të erës me kosto deri në 7400 MW dhe Agjencia propozon në skenarin e saj Remap një kapacitet të instaluar të erës prej 616 MW deri në vitin 2030, me një potencial kapaciteti vjetor gjenerues prej 1794 GWh.

**3.5.3 UNECE<sup>16</sup> - Zhvillimet në Energjinë e Rinovueshme në Shqipëri (Qershor 2021)** Publikimi ofron të dhëna gjithëpërfshirëse mbi burimet e rinovueshme në Shqipëri si edhe fokusohet në masat për mbështetjen e energjisë së rinovueshme duke theksuar: (i) Asetet e rinovueshme në shkallë të vogël në Shqipëri janë të pranueshme për tarifën nxitëse të garantuara nëpërmjet blerjes së detyrueshme të energjisë nga operatori i sistemit të shpërndarjes (OSSH); (ii) Projektet e shitjes së shërbimeve komunale janë nxjerrë në ankand dhe financohen nëpërmjet një skeme Kontratë për Diferencat (CfD).

<sup>16</sup> <https://unece.org/sites/default/files/2021-07/UNECE-RE-Uptake-Factsheet-Albania.pdf>

Shqipëria ishte një nga vendet e para në rajonin e Evropës Juglindore që prezantoi ankandet për projektet e energjisë së rinovueshme dhe që atëherë ka tenderuar me sukses projekte FV me çmime konkurruese; (iii) Net-matja njihet për sistemet diellore dhe me erë të vogla dhe të mesme deri në 500 KW; (iv) Disa përjashtime nga taksat doganore zbatohen për makineritë dhe pajisjet e përdorura në ndërtimin e të gjitha termocentraleve, duke përfshirë termocentralet e rinovueshme dhe konvencionale.

Për qëllime të këtij dokumenti, u konsultuan edhe *draft-Programi i Reformave Ekonomike 2023-2025*<sup>17</sup> (ERP) dhe *Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve*<sup>18</sup> (BIDS). ERP i referohet objektivave të Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës *për rritjen e sasisë së energjisë së rinovueshme në konsumin final me 59.4% krahasuar me 54.4%*. BIDS nuk përmban përaftrim sektorial, por thekson se *prodhimi i energjisë nga burimet e rinovueshme duhet të konsiderohet avantazh strategjik për vendin.*

<sup>17</sup> <http://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/596>

<sup>18</sup> <https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2021/10/Strategjia-e-Zhvillimit-t%C3%AB-Biznesit-dhe-Investimeve.pdf>



# ZHVILLIMET NË SEKTOR

## 1. ZHVILLIMET KRYESORE LIGJORE

» Në vitin 2017, Shqipëria miratoi Ligjin Nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të burimeve të rinovueshme të energjisë” në përputhje me Traktatin e Komunitetit të Energjisë që transponon pjesërisht Direktivën nr. 2009/28/EC “Për Burimet e Rinovueshme të Energjisë”. Ky ligj parashikon “skema nxitëse<sup>19</sup>” si një angazhim i drejtpërdrejtë i qeverisë për të arritur objektivin për përdorimin e energjisë së prodhuar nga burimet e rinovueshme. Ligji parashikon miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Energjinë e Rinovueshme (NREAP), i cili, ndër të tjera, përcakton objektivat për pjesën e energjisë së rinovueshme në konsumin total të energjisë në vend, duke përfshirë energjinë elektrike, transportin, ngrohjen dhe ftohjen. . Për më tepër, ai përcakton politikën dhe masat mbështetëse për arritjen e këtyre objektivave.

» Një draft i ri për burimet e rinovueshme është përgatitur dhe i është nënshtruar pro-

cedurave të konsultimit publik<sup>20</sup>. Projektligji prezanton një trajtim më fleksibël të vetë-konsumatorit të burimeve të rinovueshme. Ligji aktual parashikon që, në përputhje me skemën e matjes, një ndërmarrje e vogël ose e mesme ose një klient familjar mund të instalojë një kapacitet total deri në 500 kw për prodhimin e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme (erë ose diellore) për të mbuluar një pjesë ose të gjithë energjinë e nevojshme për nevoja personale/biznesi dhe të injektojë energjinë e tepërt të prodhuar në rrjetin e shpërndarjes.

» Drafti i ri parashikon që vetë-konsumatorët e rinovueshëm do të kenë një kapacitet maksimal prej 500 kw dhe do të kenë të drejtë të gjenerojnë, konsumojnë, ruajnë dhe shesin prodhimin e tepërt të energjisë elektrike të rinovueshme, përfshirë përmes marrëveshjeve dypalëshe, furnizuesve të energjisë elektrike dhe marrëveshjeve tregtare me homologët, pa u përballur me ngarkesa diskriminuese apo disproporcionale. Të drejtat dhe përgjegjësitë e

19 Suport me tarifa të rregulluara (feed-in-tariff) dhe CoD (Feed-in-premium)

20 <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/517>

vetë-konsumatorëve të rinovueshëm do të përcaktohen me anë të një VKM-je<sup>21</sup>.

» NREAP përditësohet çdo dy vjet dhe i fundit është miratuar në shtator 2019 si një Plan Veprimi i konsoliduar për vitet 2019-2020. Ky plan veprimi zëvendësoi NREAP e mëparshëm për 2018-2020 duke reduktuar objektivat për prodhimin e energjisë nga hidrocentralet dhe duke rritur objektivat për energjinë diellore dhe të erës në një përpjekje për të diversifikuar përzierjen e energjisë përmes depërtimit të teknologjive më të gjera të energjisë së rinovueshme. NREAP do të zëvendësohet nga Plani Kombëtar i Energjisë dhe Klimës (NECP), i cili është në fazë finalizimi dhe do të përcaktojë objektivat e energjisë së rinovueshme deri në vitin 2030<sup>22</sup>.

» Strategjia Kombëtare për Energjinë 2030<sup>23</sup> - Qeveria është angazhuar për një politikë të rritjes së përdorimit të energjisë së rinovueshme, kryesisht hidro, diellore dhe të erës. Vendi është i ekspozuar në një shkallë të konsiderueshme ndaj rrezikut të pasigurisë së fur-

21 Vendimi i Këshillit të Ministrave, ndër të tjera do të parashikojë:

- Skemën e kompensimit të rinovueshme të vetë-konsumatorit bazuar në metodologjinë e faturimit neto;
- Procedurën e aplikimit për vetëkonsumatorët e rinovueshëm, duke përfshirë afatet përkatëse;
- Kërkesat teknologjike dhe teknike duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në, përmirësimet e nevojshme të sistemit të matjes për të bërë të mundur zbatimin e skemës së kompensimit;
- Rregullat për shitjen e energjisë së prodhuar vetë;
- Shpërblymimi për energjinë elektrike të prodhuar nga konsumatorët e vetë rinovueshëm, i përcaktuar nga ERE në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave;
- Çmimi i energjisë elektrike i prodhuar nga vetë-konsumatorët e rinovueshëm duhet të sigurojë një kompensim të drejtë që pasqyron vlerën e tregut të energjisë së furnizuar në rrjet dhe do të shmangë ndërshtetërisht ose diskriminimin e padrejtë midis vetë-konsumatorëve të rinovueshme dhe klientëve të tjerë. Çmimi i energjisë elektrike merr parasysh edhe kostot e bëra për sistemin e transmetimit, shpërndarjes dhe balancimit;
- Periudha vjetore që do të shërbejë për të matur prodhimin e tyre.

22 <https://www.infrastruktura.gov.al/wp-content/uploads/2021/12/Vlersimi-Strategjike.pdf> <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/421>

23 Miratuar me VKM Nr. 480 datë 31.07.2018

nizimit, për shkak të ndryshimeve në kushtet hidrologjike dhe mosdiversifikimit. Strategjia Kombëtare e Energjisë 2018-2030” përfshin ndryshimet e nevojshme të nevojshme për rritjen e sigurisë së furnizimit me energji dhe optimizimin e burimeve për plotësimin e nevojave me objektivin kryesor zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë.

Figura 6. Objektivat strategjikë në energji 2030

Përshkrimi	Pikënisja 2015	Objektivat 2030
Humbjet në rrjetin e shpërndarjes	31.4%	10%
Humbjet në rrjetin e transmetimit	2.2%	1.7%
Arkëtimet e energjisë	90%	98%
Pjesa e burimeve primare vendase të energjisë në TPES	47.5%	52.4%
Pjesa e energjisë së rinovueshme në TPES	32.5%	42%
Pjesa e biofuel në totalin e energjisë së konsumuar në transport	3.5%	10%

Burimi: Strategjia Kombëtare e Energjisë 2018-2030

Zhvillimet e mësipërme mbështeten nga Kuadri Institucional, një pjesë e të cilit është detajuar në Aneksin 1.

# GJETJE DHE ANALIZA

Gjetjet përmbledhen në tre shtylla kryesore sipas shqetësimeve të ngritura nga bizneset gjatë takimeve dhe fokus grupeve: (i) marrja e energjisë dhe parakushtet që bizneset identifikojnë me rëndësi të madhe për aktivitetin e tyre - investime të mëtejshme në rrjetin e shpërndarjes; (ii) përmirësime të pritshme të natyrës ligjore dhe rregullatore që mund të mbështesin potencialisht rritjen e investimeve në burimet e rinovueshme; (iii) sfidat dhe mundësitë për NVM-të në kuadër të aksesit në financim për burimet e rinovueshme. Sekretariati gjatë konsultimeve për përgatitjen e këtij Dokumenti Pune evidentoi se nxitja e përdorimit të burimeve të rinovueshme të energjisë dhe futja e tyre në tregun e energjisë ka patur një fokus të shtuar në vitet e fundit në

Shqipëri jo vetëm në raport me kuadrin ligjor të miratuar apo atë në proces. Këtu mbahet parasysh fakti se kapacitetet e lejuara aktualisht deri në 500 kW për instalimin e njësize gjeneruese të prodhimit të energjisë elektrike nga era ose dielli nga një shoqëri e vogël ose e mesme apo një klient familjar, është nga më të lartat në rajon (ku varion zakonisht deri në 200kW). Zhvillimi i BRE, në këtë rast i kapaciteteve të gjeneruara nga vetëprodhuesit duhet të konsiderojë dhe kapacitetet e kufizuara të rrjetit të shpërndarjes, domosdoshmërinë e tij për investimeve<sup>24</sup> (të kufizuara në vitet e fundit nga krizat e njëpasnj

<sup>24</sup> Vlerësohet se pavarësisht humbjet teknike në rrjet me 1%, kërkojnë rreth 50 Mln Eur në rrjetin e shpërndarjes


jëshme) dhe sforcimin buxhetor për mbajtjen të stabilizuar të cmimit për konsumatorët (me përjashtim të vetëm 59 kompanive të cilat për shkak të liberalizimit të tregut kanë cmim të parregulluar).

» Nga ana tjetër evidentohen një sërë dinamikash dhe iniciativash në fushën e optimizimit të konsumit, projekteve për mbështetjen dhe incentimin e familjeve të cilat instalojnë panele diellore (70% grant për koston e investimit), kursimit të energjisë nga institucionet publike (vendosja e administratorëve të energjisë) dhe projekteve dhe iniciativave për nxitjen e efikasitetit në ndërtesa. Në fund vlen të theksohet se projektligji i ri për nxitjen e përdorimit të burimeve të rinovueshme (tashmë në procedurat parlamentare) pritet të sjellë një impetus të ri në lidhje me BRE dhe të adresojë edhe një pjesë të konsiderueshme të gjetjeve dhe rekomandimeve të përfshira në këtë Dokument Pune.


## 1. PERCEPTIMI I NVM-VE MBI NDËRGJEGJËSIMIN MBI BURIMET E PËRFTIMIT TË ENERGJISË DHE SFIDAT

» Një rrjet i qëndrueshëm i përfutimit të energjisë perceptohet si i domosdoshëm dhe ndikon drejtpërdrejt në mbarëvajtjen e aktivitetit të biznesit, konfirmuar nga 88% e kompanive të intervistuar. Përafërsisht, 1 në 6 kompani deklaroi se nuk ka pasur ndërprerje të energjisë elektrike në një muaj, 64% e kompanive kanë pasur deri në 5 ndërprerje të energjisë elektrike gjatë një muaji, ndërsa 17% prej tyre më shumë se 5 herë në muaj.

**Figura 7. Impakti i ndërprerjes së energjisë në aktivitetin e biznesit**




**Figura 8. Ndërprerjet e energjisë**



Burimi: Anketa e Sekretariatit

» Nisur nga krizat më të fundit globale energjetike dhe ndryshimeve në tregjet e energjisë, sektori privat është i vetëdijshëm për burime të tjera alternative të prodhimit të energjisë, përveç energjisë hidro. Megjithatë, kostot e larta të investimit fillestar duket se janë pengesa kryesore në vendimin për të investuar në burime alternative të energjisë (mendimi i 64% të kompanive të intervistuar). Më shumë se 9 nga 10 kompani kanë informacion për burime alternative dhe 22% e tyre kanë investuar edhe pse me mendime të ndryshme për efektivitetin e tyre.


**Figura 9. Familiariteti me burimet alternative të prodhimit të energjisë**



Burimi: Anketa e Sekretariatit

- » **Eficientia e energjisë, si një formë e uljes së kostos së energjisë, njihet mirë nga bizneset (95%) dhe 1 në 5 kompani ka bërë disa investime në këtë drejtim. Në përgjithësi, vendimi për të investuar në efikasitetin e energjisë ose në burime të tjera alternative të energjisë shoqërohet me pasigurinë e efikasitetit të saj dhe kostot e larta që lidhen me të.**


**Figura 10. Familiariteti me opsionet e efikasitetit të energjisë**



Burimi: Anketa e Sekretariatit

- » Vendimi i një kompanie për të investuar në efikasitetin e energjisë dhe/ose burimin alternativ të energjisë ndikohet kryesisht nga aftësia për të ulur koston e energjisë dhe furnizimin e sigurt me energji.

**Figura 11. Faktorët që ndikojnë në vendimarrjen e investimit në efikasitetin e energjisë/burime alternative**



Burimi: Anketa e Sekretariatit

## 2. AGJENDA E GJELBËR DHE EFIÇENCA E ENERGJISË NË QËNDËR TË PRIORITIVË TË KOMPANIVË DHE QEVERISË

Çështjet e mëposhtme janë renditur siç janë identifikuar nga bizneset gjatë takimeve, intervistave, fokus grupeve dhe pyetësorëve. Është bërë një analizë e thellë e çështjeve për të harmonizuar gjetjet aktuale me arsyetimin dhe kuadrin aktual ligjor dhe rregullator. Çështjet e ngritura përmbledhen në 5 kategori kryesore: (A) ligjore dhe rregullatore; (B) çështjet teknike; (C) konkurrueshmëria; (D) ekonomike dhe financiare; (E) lehtësimin e procedurave dhe aksesin në informacion.

### A. LIGJORE DHE RREGULLATORE

- » **Megjithë progresin e bërë me miratimin e një legjislacioni të dedikuar për burimet**

**e rinovueshme në vitin 2017, ka ende nevojë për përmirësimin dhe/ose zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullator aktual primar dhe sekondar që rregullon energjitë e rinovueshme, që mund të lehtësojë dhe optimizojë investimet në këtë fushë.** Konkretisht, optimizimi, stimulimi dhe racionalizimi i investimeve në panele fotovoltaike nga bizneset (vetëprodhuesit e energjisë) kufizohen nga mungesa e përfitimit nga shkëmbimi i tepricave të energjisë së prodhuar në rrjetin e shpërndarjes. Bizneset pretendojnë se skema aktuale e matjes neto (netimi midis energjisë elektrike të prodhuar dhe të konsumuar) nuk ndihmon për një sistem tregu të drejtë, pasi tepricat e energjisë shpërndahen falas në rrjetin e shpërndarjes. Kjo vjen kryesisht për shkak të mosmiratimit dhe zbatimit të skemës së matjes neto të energjisë elektrike në baza vjetore, si dhe mungesës së metodologjisë për përcaktimin e çmimit të shitjes në tregun e derregulluar.

Për sa më sipër, nga analiza jonë ne identifikuam sa vijon:

- » Mos-miratimi i “Skemës së matjes neto të energjisë elektrike” me bazë vjeçare (aktualisht aplikohet skema me bazë mujore), në alternim dhe me mos-miratimin e “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së tepricave tek Furnizuesi i Shërbimit Universal, i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik”, klasifikon një pjesë të projekteve si jo rentabël nga aspekti ekonomik. Gjithashtu, ky alternim “detyron” një pjesë të konsiderueshme të vetëprodhuesve, të instalojnë fuqi më të vogël se konsumi i pritshëm (duke u ekspozuar në çmimet e larta të tregut të energjisë elektrike në muajt me prodhim energjie

elektrike më të vogël), ose të instalojnë fuqi më të madhe se konsumi i pritshëm (duke u ekspozuar në “dhurimin” e tepricave).

- » Mos-miratimi i “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së tepricave tek Furnizuesi i Shërbimit Universal, i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik”, ku teprica mujore i kalon Furnizuesit të Shërbimit Universal pa kundërshpërblim. Shumë projekte në kuadrin e instalimit të paneleve fotovoltaike në cilësinë e vetëprodhuesve nuk janë materializuar për arsye të mos-miratimit të kësaj metodologjie. Mos-miratimi i metodologjisë, në alternim dhe me aplikimin e skemës netuese me bazë mujore, i klasifikon një pjesë të projekteve si jo rentabël nga aspekti ekonomik.
- » Mos-miratimi i “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga vetëprodhuesit aktivë në tregun e parregulluar”. Shumë projekte në kuadrin e instalimit të paneleve fotovoltaike në cilësinë e vetëprodhuesve janë materializuar nga konsumatorë të energjisë elektrike të lidhur në tensionin e mesëm (6 kV – 20 kV). Kjo kategori, në alternim të neneve 86.6 dhe 109.1 të ligjit Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, parashikohet të furnizohet nga tregu i parregulluar pas datës 31.12.2023. Në këto kushte, do të jetë praktikisht e pamundur që të aplikohet skema neto me bazë mujore apo vjeçare (siç aktualisht pamundësohet për konsumatorët e energjisë elektrike të lidhur në tensionin 35 kV), ku Furnizuesi i Shërbimit Universal të jetë blerësi i energjisë elektrike të prodhuar nga paneli fotovoltaik i vetëprodhuesit, ndërsa konsumi i energjisë elektrike i këtij vetëprodhuesi të furnizohet nga furnizues alternativ.

- » **Mungesa e legjislacionit dytësor që mbështet ndërtimin e parqeve me erë për qëllime vetëkonsumimi zvogëlon mundësitë për burimet e rinovueshme.** Disa biznese, p.sh., në Durrës që operojnë në fushën e strukturave akomoduese të agroturizmit ishin të interesuar të investonin në strukturat eolike/tokësore si një mjet për të përfitur nga karakteristikat e erës së zonës ku ndodhej biznesi i tyre. Sipas tyre, megjithëse struktura të tilla supozohej të prodhonin energji në një sasi të vogël dhe për qëllime vetë-konsumimi, nuk kishte asnjë kornizë për të përmirësuar procesin e ndërtimit dhe funksionimit të tyre.
- Nga analiza rezulton mos-miratimi i Udhezimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë *“Për miratimin e procedurës së lehtësuar të autorizimit për lidhjen në sistemin e shpërndarjes të projekteve të vogla të rinovueshme për vetëprodhuesit e energjisë elektrike nga era”*, ku aktualisht procedurat e lehtësuara janë miratuar vetëm për vetëprodhuesit e energjisë elektrike nga dielli. Legjislacioni primar e ka klasifikuar prodhimin e energjisë elektrike nga era, si prodhim objekt i skemës neto të matjes së energjisë elektrike. Mos-miratimi i procedurës së lehtësuar pamundëson një pjesë të konsiderueshme të investitorëve të interesuar (kryesisht ata që nuk kanë mundësi praktike të instalojnë panele fotovoltaike), të ekspozohen në çmimet e larta të tregut të energjisë elektrike pa mundësi alternative.
- » **Ka njëfarë mospërputhjeje ndërmjet dispozitave ligjore që lidhen me fuqinë maksimale të instaluar në dispozicion të konsumatorëve, me sa duket për shkak të miratimit të legjislacionit në momente të**

#### **ndryshme të reformës energjetike.**

Analiza nxorri në pah nevojën për harmonizimin më të mirë të dispozitave ligjore të përcaktuara në nenet 37.6.b (1MW) dhe 49.4 (1 MW), të ligjit Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, me ato të nenit 15.1 (0.5 MW), të ligjit Nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, duke unifikuar fuqinë e instaluar të vetëprodhuesve me kapacitet maksimal prej 1 MW. Konsumi i moderuar i konsumatorëve të lidhur në tensionin e mesëm, kapacitetin maksimal prej 1 MW e konsideron mëse të mjaftueshëm për të akomoduar nevojat me energji elektrike për (pothuajse) të gjithë konsumatorët e lidhur në këtë segment.

- » **Pamundësia për të tregtuar “certifikatat e gjelbra” në një treg rajonal (konstatohet mungesa e një tregu vendas që lidhet me tregtimin e këtij instrumenti, të paktën në afat të shkurtër), pengon që procedurat e BRE (kryesisht ato pa mbështetje shtetërore) të kenë akses në burime financiare shtesë.** Në këto kushte, me miratimin e mundësisë së tregtimit të këtij instrumenti, investimet në këtë segment bëhen shumë më tërheqëse, kryesisht duke marrë parasysh vlerat financiare mjaft të qenësishme që gjenerojnë (aktualisht) “certifikatat e gjelbra”.

Rezultoni mos-miratimi i procedurave lidhur me tregtimin e “certifikatave të gjelbra”. Tregtimi i “certifikatave të gjelbra” parashikohet në Direktivën e BE 2009/28/EC (23 prill 2009), transpozuar në legjislacionin shqiptar nëpërmjet Vendimit të Këshillit Ministerial të Komunitetit të Energjisë Nr. 2012/04/MC-EnC (18 tetor 2012).

- » **Pamundësia e tregtimit të “garancive të origjinës” në tregun lokal apo atë rajonal, pamundëson gjeneruesit e energjive të rinovueshme (kryesisht ata që nuk kanë mbështetje shtetërore) të kenë akses në burime financiare shtesë. Me miratimin e mundësisë së tregtimit të instrumentit, investimet në këtë segment bëhen më atraktive.**

Nga analiza jonë rezultoi mos-miratimi i procedurave lidhur me tregtimin e “garancive të origjinës”. Tregtimi i “garancive të origjinës” parashikohet në Direktivën e BE 2009/28/EC (23 prill 2009), transpozuar në legjislacionin shqiptar nëpërmjet Vendimit të Këshillit Ministerial të Komunitetit të Energjisë Nr. 2012/04/MC-EnC (18 tetor 2012). Gjithashtu, parashikohet qartësisht në nenin 16, të ligjit Nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”.

- » **Aktualisht, energjia elektrike që prodhohet nga vetëprodhuesit, shkëmbehet vetëm me Furnizuesin e Shërbimit Universal. Gjithashtu, nuk janë miratuar parimet për integrimin e vetëprodhuesve nga energjia e rinovueshme dhe “Komuniteteve të Energjive të Rinovueshme” në sektorin e energjisë elektrike. Miratimi i këtij propozimi do të çlironte energji dhe oportunitete të reja, jo vetëm për konsumatorët, prodhuesit, vetëprodhuesit si dhe tregtarët e energjisë elektrike, por do të mundësonte dhe krijimin e një tregu likuid të energjisë elektrike, me përfitime të qenësishme për të gjithë pjesëmarrësit e tij.**

Në lidhje me sa më sipër, nga analiza jonë u identifikua mos-miratimi i parimeve të funksionimit të “Agreguesit” si dhe “Komuniteteve të Energjive të Rinovueshme”. Miratimi i parimeve të mësipërme do të mundësonte që “Komuniteti i Energjive të Rinovueshme” të prodhojë, konsumojë, depozitojë, ndajë, shesë energji, ofrojë agregim si dhe të ketë akses në të gjitha tregjet e energjisë, drejtpërdrejt ose nëpërmjet agregimit. “Agregimi” do të mundësonte kombinimin e ngarkesave të shumta të konsumatorëve ose energjisë së prodhuar për shitje, blerje ose tregtim në çdo treg energjie.

#### **B. ASPEKTE TEKNIKE**

- » **Pavarësisht përmirësimeve të bëra, garantimi i parametrave të cilësisë së furnizimit me energji elektrike sipas standardeve të BE, evitimi i ndërprerjeve të shpeshta të furnizimit dhe i luhatjeve të tensionit të rrjetit mbi normat teknike të lejuara nga teknologjitë, makineritë dhe pajisjet e instaluar nga segmenti i SME, mbetet ende një sfidë.**

Parametrat e cilësisë së furnizimit me energji elektrike, janë pasqyruar në “Rregulloren për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, miratuar nëpërmjet Vendimit të ERE Nr. 181, datë 10.11.2017. Parametrat kryesorë të cilësisë, për vitin 2021, pasqyrohen në Vendimin e ERE Nr. 97, datë 07.04.2021 “Mbi miratimin e treguesve për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2021”, i më poshtë:

- Cilësia e Frekuencës (FQ): Kufiri normal i operimit: 49.8 → 50.2 Hz. Gjatë çrregullimeve të sistemit: 48.0 → 52.0 Hz.

- Cilësia e Tensionit (VQ): 230 V → 400 V = -10% → +5%: 6,000 V → 110,000 V = -5% → +5%.
- Periudha e Njoftimit të Ndërprerjeve të Planifikuara në Sistemin e Shpërndarjes = 72 orë.

Nga një analizë e bazës ligjore të aplikueshme si dhe problematikave të adresuara nga NVM-të, rezulton që:

- ERE nuk ka miratuar treguesit për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike për vitet 2022 dhe 2023, duke i pamundësuar konsumatorëve të energjisë elektrike aksesin në një informacion vital lidhur me performancën e pritshme të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes si dhe ushtrimin e të drejtave të tyre përkatëse.
- ERE nuk ka miratuar “vlerën e kompesimit” të konsumatorëve në rast të mosrespektimit të kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit sipas përcaktimeve të “Rregullores për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, miratuar nëpërmjet Vendimit të ERE Nr. 181, datë 10.11.2017, duke i pamundësuar konsumatorëve të energjisë elektrike adresimin e kërkesave për kompesim përkundrejt Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.

Miratimi i treguesve për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike për vitet 2022 dhe 2023 (dhe në vijim për çdo vit kalendarik), duke u alternuar dhe me miratimin e “vlerës së kompesimit”

të konsumatorëve në rast të mosrespektimit të kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit, do të pas-sillte, jo vetëm një qendrueshmëri nga aspekti rregullator, por dhe sensibilizimin e konsumatorëve si dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes lidhur me standardet e cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike.

» **Detyrimi aktual për vendndodhjen e detyrueshme (ndërlidhja) e njësive gjeneruese të energjisë elektrike në të njëjtin ambjent me njësinë konsumuese të energjisë elektrike, kufizon investimet në fotovoltaike dhe korrespondon me gjendjen faktike që operojnë bizneset. Heqja e këtij kufizimi jo vetëm që do të përfshinte një gamë shumë më të gjerë aplikantësh, por do të mundësonte edhe shfrytëzimin e tokave/sipërfaqeve të vogla aktualisht joproductive. Propozimi është bërë i mundur nëpërmjet materializimit të instalimit të dy matësve (një për prodhim dhe një për konsum), si dhe rrjetëzimit të tyre në bazë të rezolucionit në fuqi (mujore ose vjetore).** Nga një analizë e dispozitave të ligjit Nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 3, datë 20.06.2019 “Për miratimin e procedurës së lehtësuar të autorizimit për lidhjen në sistemin e shpërndarjes të projekteve të vogla të rinovueshme për vetëprodhuesit e energjisë elektrike nga delli”, rezulton që vendndodhja e njësive gjeneruese të energjisë elektrike duhet të jetë në të njëjtin ambjent me njësinë konsumuese të energjisë elektrike të vetëprodhuesit (një matës me dy drejtime). Kufizimi i mësipërm jo vetëm konsiderohet si jo i nevojshëm nga

aspekti teknik, por limiton mjaftueshëm të gjithë investitorët potencialë në kuadrin e vetëprodhuesve. Nga komunikimet me SME, rezulton që në mjaft raste, konsumatorët jo vetëm nuk kishin hapësira të mjaftueshme për të instaluar panele diellore në njësinë e konsumit, por, dhe në rast se do të ishte e mundshme, do të kishte një efekt negativ në peisazhin e ofruar (kryesisht në njësitë konsumuese me karakter akomodues).

» **Pavarësisht specifikimit ligjor lidhur me reduktimin në sasi dhe në kohë piku të konsumit të energjisë elektrike, ERE ka miratuar tarifa vetëm për dekurajimin e konsumit të energjisë elektrike në kohë piku, pa alokuar asnjë incentivë për konsumin e energjisë elektrike në orët e natës/fashat me konsum të ulët, duke privuar konsumatorët e impaktuar nga reduktimi i mëtejshëm i kostove lidhur me energjinë elektrike.**

Në nenin 3.12, të ligjit Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, përcaktohet që: “Eficienca e energjisë/menaxhimi i kërkesës” është përdorimi i energjisë elektrike në mënyrë të tillë që të ndikojë në reduktimin në sasi dhe në kohë piku të konsumit të energjisë elektrike. Aktualisht, Furnizuesi i Shërbimit Universal faturon energjinë elektrike tek konsumatorët SME (ata të lidhur në tensionin 0.4 kV), bazuar në tarifat e miratuara nga Enti Rregullator i Energjisë. Tarifat e furnizimit për konsumatorët e lidhur në tension të mesëm janë të liberalizuara, ndërkohë që për nivelin e tensionit të ulët (0.4 kV), miratohen bazuar në parimet e “Metodologjisë së Përcaktimit të Çmimeve për Shitjen e Energjisë Elektrike me Pakicë tek Klientët Fundorë që Furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU)”, miratuar

nëpërmjet Vendimit të ERE Nr. 189, datë 23.11.2017. Bazuar në tarifat aktuale, konsumatorët e lidhur në tension të ulët (0.4 kV) paguajnë një tarifë prej 14 lekë/kWh për periudhën “bazike”, ndërkohë, për periudhën 1 nëntor - 31 mars, ora 18:00 deri në 22:00, dhe, për periudhën 1 prill - 31 tetor, ora 19:00 deri në 23:00, paguajnë një tarifë prej 16.1 lekë/kWh. Për konsumatorët “Furra buke dhe prodhim mielli në 0.4 kV”, paguajnë respektivisht 7.6 dhe 8.74 lekë/kWh.

Mbi bazën e praktikave më të mira të industrisë, ERE mund të miratojë stimuj në lidhje me kalimin e konsumit nga brezi i pikut (si rrjedhojë, çmimet mjaft të larta) në intervalin jashtë pikut (çmime mjaft të ulëta). Kjo jo vetëm që do të reduktonte nevojën për blerje të energjisë elektrike dhe disponueshmërinë e rezervave me çmime mjaft të shtrenjta, por do të ulte në fund edhe kostot e energjisë elektrike për NVM-të. ERE, ose mund të miratojë çmime më të ulëta për konsum jashtë pikut, ose të prezantojë matësa që funksionojnë/matin një konsum më të ulët në një rezolucion të tillë.

### C. ASPEKTE TË KONKURRUESHMËRISË

» **Trajtimi me çmime/njësi të energjisë elektrike të diferencuara për të njëjtën kategori biznesesh, u konsiderua si një nga problematikat më kapilare të impaktit të krizës në sektorin e energjisë elektrike.**

Nga analiza jonë rezultoi se konsumatorët e lidhur në nivelin e tensionit 6 kV - 20 kV, furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit (FSHU sh.a.) me çmim/njësi 18.26 lekë/kWh, për periudhën 01.08.2022 – 31.12.2022 (Vendimi i ERE Nr. 229, datë 12.09.2022), ndërkohë që konsumatorët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV – 220 kV ekspozohen

në çmimet e tregut ndërkombëtar të energjisë elektrike. Konsumatorët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV mund të furnizohen dhe nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit (FSHU sh.a.) me çmime tregu, specifikisht 31.50 lekë/kWh (Vendimi i ERE Nr. 287, datë 10.11.2022, i aplikueshëm për muajin tetor 2022). Konsumatorët e lidhur në tensionin e mesëm, specifikisht 6 kV, 10 kV, 20 kV dhe 35 kV, pavarësisht nivelit të ndryshëm të tensionit, kanë të njëjtën natyrë biznesi (në çdo rast konsiderohen si NMV), dhe, përballja me kosto diametralisht të ndryshme në furnizimin me energji elektrike, ka pasur impakt direkt dhe të qenësishëm, jo vetëm në konkurrueshmërinë e tyre por dhe në konkurrencën ndërmjet tyre.

Gjatë intervistave tona na rezultoi se disa biznese NMV, në përpjekje për të optimizuar kostot lidhur me furnizimin me energji elektrike, në disa raste, ka pas-sjellë dhe rilidhjen e konsumatorëve në nivele tensioni më të ulëta, specifikisht nga 35 kV në nivelet 6 kV, 10 kV, 20 kV, duke pasur një efekt negativ në qëndrueshmërinë e sistemit elektroenergjitik si dhe furnizimin e konsumatorëve (të tjerë) të energjisë elektrike me cilësinë e kërkuar. Mirëpritet nisma e KESH – FTL, për të mundësuar furnizimin e segmentit 35 kV me çmime të moderuara të tregut, të paktën për vitin 2023<sup>25</sup>.

#### D. ASPEKTE EKONOMIKO – FINANCIARE

- » **Mbështetja e projekteve në sektorin e energjisë elektrike, nëpërmjet mbështetjes buxhetore, i projekteve në sektorin e energjisë elektrike, aktualisht kufizohet**

25 <https://oshee.al/klientet-35kv-zhvillohet-ankandi-per-berjen-e-energji-e-elektrike-nga-1-janar-31-dhjetor-2023-lista-e-pjesemarrësve/>

**vetëm në segmentin e konsumatorëve familjarë, specifikisht në panele diellore për ngrohjen e ujit. Kjo skemë synon nxitjen e përdorimit të paneleve diellore për ngrohjen e ujit nga konsumatorët familjarë nëpërmjet subvencionimit në masën 70 % të kostos nga Agjencia për Efiçencën e Energjisë. Bazuar në të dhënat e ERP<sup>26</sup>-së, shuma totale e dedikuar për sigurinë energjetike përmes promovimit të burimeve të rinovueshme të energjisë dhe përmirësimeve të efiçencës së energjisë vlerësohet në 127 milionë euro në vitin 2023, 474 milionë euro në vitin 2024 dhe 888 mijë euro në vitin 2025.**

Duke marrë parasysh sfidat e sipërpërmendura të NVM-ve, mbështetja aktuale e kufizuar buxhetore vendase dhe praktikrat më të mira që rezultojnë nga vendet evropiane (si subvencionimi i drejtpërdrejt i mikro-investimeve në sektorin e energjisë së rinovueshme, kryesisht vetë-prodhuesit<sup>27</sup>), disa përfaqësues të sektorit privat në sektorë si turizmi përmendën nevojën të merret në konsideratë përcaktimi i politikave më tërheqëse dhe nxitëse që promovojnë energjitë e rinovueshme dhe efiçencën e energjisë duke marrë parasysh lehtësimin tatimor dhe fiskal në lidhje me TVSH-në e aplikueshme për makineritë dhe pajisjet dhe heqjen e “taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja” për zhvillimin e projekteve në sektorin e energjisë. Sekretariati është i vetëdijshëm se lehtësime të tilla kërkojnë një analizë shteruese të implikimeve fiskale dhe buxhetore nga MFE-ja. Për këtë qëllim, sa vijon në tabelën më

26 Informacioni është shuma totale dhe jo ndarja sipas burimit të financimit (buxheti, granti nga partnerët e zhvillimit/të tjera)

27 Sikurse edhe për efiçencën e energjisë

poshtë nuk janë miratuar si rekomandime të drejtpërdrejta, por më tepër tema për një diskutim më të gjerë dhe të cilat mund të analizohen dhe miratohen potencialisht si rekomandime nga KI.

1. Dinamika e çmimeve të energjisë- duke konsideruar që një kWh i prodhuar nga njësi gjeneruese lokale, zëvendëson një kWh të importuar (çmimi mesatar në tregun rajonal për vitin 2022 është ~276 Euro/MWh)<sup>28</sup>. Kësisoj, vlen të konsiderohet me kujdes çdo taksë e vendosur lidhur me prodhimin e energjisë elektrike në Shqipëri, duke qenë se mund të funksionojë në mënyrë dekurajuese për investimet e reja në sektorin e energjive të rinovueshme. Në këtë kontekst, gjatë analizave tona përfaqësuesit e NVM-ve ishin në dijeni të përjashtimit nga TVSH-ja e makinerive dhe pajisjeve që kanë të bëjnë me prodhimin e energjisë së rinovueshme nga dielli, por kërkuan që të merret parasysh heqja e TVSH-së për makineritë dhe pajisjet pa kufizime në lidhje me burimin e energjinë, fuqinë e instaluar dhe vlerën e investimit. Kështu, duke ju referuar VKM Nr. 212, datë 20.04.2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr. 953, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave “Për dispozitat zbatuese të ligjit Nr. 92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, lista e makinerive dhe e pajisjeve parashikohet vetëm në funksion të realizimit të kontratave të in-

28 <https://hupx.hu/en/market-data/dam/historical-data>

vestimit për prodhimin e energjisë së rinovueshme nga dielli, me fuqi të instaluar prodhimi mbi 0.5 MW, dhe me vlerë investimi mbi 50 milionë lekë.

2. Gjithashtu, në nenin 27.3.b), të ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar) përcaktohet: “Për projekte të infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroportëve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte, taksë e ndikimit në infrastrukturë të ndërtimeve të reja është 0.1 (zero pikë një) për qind e vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar, kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit. Për të promovuar zhvillimin e projekteve në sektorin energjitik, dhe specifikisht atë të burimeve të rinovueshme, si dhe me qëllim unifikimit e praktikave të qeverisjes lokale, kërkohet heqja e “Taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja”.

- » Bashki të ndryshme kanë zbatuar aplikime dhe interpretime të ndryshme për taksën vendore “Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja” për punimet dhe ndërtimin e paneleve fotovoltaike. Në disa bashki (p.sh. Vlorë dhe Maliq) aplikohet taksë e ndikimit në infrastrukturë, ndërsa në bashki të tjera (p.sh. Tiranë dhe Korçë), nuk parashikohet dhe zbatohet asnjë taksë për këto punime. Duket se mungon një qasje e unifikuar në lidhje me taksat vendore, ndërkohë që baza ligjore dhe arsyetimi i ndjekur nga bashkitë duket se ndryshojnë.

Nga analiza jonë e legjislationit direkt në fuqi, më konkretisht Ligji nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” (i ndryshuar), rezulton se *taksa e ndikimit në infrastrukturë zbatohet për ato punime për të cilat kërkohet leje ndërtimi*<sup>29</sup>. Sipas Rregullores për Zhvillimin e Territorit, **instalimet e paneleve fotovoltaike klasifikohen si punime për të cilat nuk kërkohet leje ndërtimi, por procedimi i tyre lejohet vetëm në bazë të deklarimit paraprak të punimeve<sup>30</sup>. Nga analizat dhe konsultimet tona, evidentohet nevoja për një qasje holistike për rritjen e ndërgjegjësimit dhe njohurive të bashkive vendore dhe aktorëve kryesorë për procedurat transparente dhe të unifikuara të aplikimit të taksës së ndikimit në infrastrukturë, duke synuar lehtësimin e investimeve nga vetë-prodhuesit në sektorin e rinovueshme. Çdo interpretim i gabuar i dispozitave të mësipërme ose i atyre që rrjedhin nga ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, megjithë ndikimin e kufizuar të tij, mund të krijojë paqartësi për individët dhe sipërmarrjet.**

## E. STIMULIMI I INVESTIMEVE TË REJA PËRMES THJESHTIMIT TË ZBATIMIT DHE ASPEKTEVE OPERACIONALE

» **Miratimi i ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, të cilat nuk janë objekt koncesioni, me fuqi të instaluar mbi 2 MW, nga Këshilli i Ministrave, konsiderohet si një proces i gjatë.** Gjatë konsultimit u evidentua interes për të investuar në këtë sektor nga investitorët vendas, padyshim për shkak të krizave aktuale ndërkombe të energjetike por jo vetëm. Në

29 Neni 46 i ligjit 107/2014.

30 Neni 7 i VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” (i ndryshuar)

këtë kuadër, duke konsideruar kompleksitetin e miratimit të një akti nga Këshilli i Ministrave si dhe afatet kohore përkatëse, kërkohet që Këshilli i Ministrave të miratojë vetëm ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni, me kapacitet të instaluar mbi 50 MW. Kjo do të mundësonte që njësitë e reja gjeneruese, me kapacitet të ulët ose të mesëm (deri në 50 MW), të miratohen nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, duke ju nënshtruar procedurave dhe afateve kohore më të shkurtra.

## QASJA NË FINANCIM PËR INVESTIME NË INSTRUMENTE TË ENERGJISË – SFIDAT DHE MUNDËSITË

*Kohët e fundit, financimi i bizneseve në fushën e energjisë ka ardhur duke u rritur ndjeshëm, për shkak të situatës së krijuar nga konflikti Rusi-Ukrainë dhe BE-ja ka qenë një nga financuesit kryesorë në këtë drejtim. BE-ja ka mbështetur për shumë vite një treg energjie më të ndërlidhur dhe më të pastër në Ballkanin Perëndimor duke zbatuar instrumente të ndryshme financimi të krijuara në partneritet me donatorë të tjerë. BERZH, GIZ, KfW, UNDP, IFC kanë mbështetur gjithashtu financimin në sektorin e energjisë. Disa nga instrumentet kryesore të financimit janë: Korniza e Investimeve të Ballkanit Perëndimor, Institucioni për Zhvillimin dhe Inovacionin e Ndërmarrjeve të Ballkanit Perëndimor, Programi Rajonal për Eficiencën e Energjisë, Fondi i Gjellbër për Rritje, Fondi Financiar i Ekonomisë së Gjellbër, Fondi Evropian për Evropën Juglindore, etj. Ne kemi përgatitur një përmbledhje të instrumenteve bazuar në informacionin e disponueshëm publik për të ndihmuar biznesin në marrjen e informacionit më aktual*<sup>31</sup>.


31 Për më shumë detaje referoju Aneksit V

## F. NDËRGJEGJËSIMI I SEKTORIT PRIVAT MBI MUNDËSITË EKZISTUESE TË FINANCIMIT DHE AKTORËT E PËRFSHIRË

Sipërmarrësit NVM-të pranojnë se janë të informuar mbi mundësitë e reja të energjisë së rinovueshme. Megjithatë, ne evidentuam një qartësi të kufizuar në kanalet e duhura të informacionit mbi aplikimet, përfitimet dhe kursimet e energjisë dhe kostot reale të investimit, si dhe për aksesin në instrumentet aktuale të financimit për energjinë e rinovueshme dhe eficiencën e energjisë.

**Ka mungesë informacioni për mundësitë alternative për investime në energjinë e rinovueshme dhe, për më tepër, një perceptim i lartë i kostove të saj, duke theksuar nevojën për më shumë fushata informuese.** 62% e kompanive të intervistuar deklaroi se nuk kanë ose kanë pak informacion mbi mundësitë e financimit të investimit në eficiencën e energjisë/ose burimet alternative të prodhimit të energjisë (më shumë se 6 nga 10 kompani).


Figura 12. Familiariteti me mundësitë e financimit të investimeve në energji



Burimi: Anketa e Sekretariatit

(1) **Bankat perceptohen si kanali investues më i njohur i përdorur nga sektori privat për të financuar investimet e tyre në eficiencën e energjisë dhe/ose burime alternative të prodhimit të energjisë.** 38% e kompanive deklaroi se njohin bankat si burim kryesor financimi për investimet në energji. *Nga takimet u konstatua se Procredit Bank kishte një linjë krediti shumë fleksibël dhe të mirëndërtuar në këtë drejtim.*

Figura 13. Familiariteti me institucionet e financimit



Burimi: Anketa e Sekretariatit

(2) **Ekziston një ndërgjegjësim i limituar i aktorëve kryesorë duke përfshirë institucionet, bizneset, bankat, etj. në lidhje me mekanizmat administrativë dhe financiarë që inkurajojnë ose lehtësojnë investimet në fushën e prodhimit të energjisë së rinovueshme.** Gjatë procesit të konsultimit në rajone të ndryshme, sektori privat theksoi mungesën e një informacioni të harmonizuar në bankat vendase dhe/ose entet publike mbi mundësitë për financimin e investimeve, kryesisht për shkak të centralizimit të informacionit.

# REKOMANDIME

## A. NË NIVEL MAKRO DHE POLITIK

**S**ipërmarrësit e NMV-ve pranojnë të kenë nevojë për më shumë njohuri dhe mbështetje mbi përballimin e pasigurive referuar tranzicionit të energjisë. Informimi më i shpeshtë mbi skemat mbështetëse për energjinë e rinovueshme do lehtësonte funksionalitetin e tyre. Për më tepër, për të ndihmuar NMV-të të rrisin qëndrueshmërinë dhe të arrijnë objektivat e Strategjisë Kombëtare të Sektorit të Energjisë 2030 të Shqipërisë, institucionet si në nivel qendror ashtu edhe në atë vendor duhet të ofrojnë mbështetje përmes sa vijon:

### REKOMANDIM 1

**MFE/MIE duhet të ndërmarrin një vlerësim të instrumenteve aktuale në dispozicion të NVM-ve, veçanërisht për ato që operojnë në sektorë kryesorë** (turizëm, ndërtim) në mënyrë që ti suportojnë ato mbi pasiguritë e tyre lidhur me burimet e financimit, kthimin e investimeve

në burimet e rinovueshme, sigurinë e energjisë dhe informacionin e saktë mbi legjislacionin në fuqi, si dhe të krijojë një listë me ndërhyrje prioritare duke u fokusuar në planet/udhërrëfyesit për NVM-të e gjelbra. Ky studim duhet të ofrojë vizionin e politikave në lidhje me (i) **Mbështetjen financiare**<sup>32</sup> (nëpërmjet granteve, kredive, subvencioneve, lehtësimit të taksave ose një kombinimi masash), që optimizojnë në mënyrë strukturore konsumin e energjisë p.sh.: zëvendësimi i pajisjeve me ato më eficientë, termo izolim etj.; (ii) **Rritja e informacionit/këshillimit** të NMV-ve (nëpërmjet rritjes së ndërgjegjësimit, udhëzimit, trajnimit, rrjetëzimit), mbi rregulloret e reja (p.sh. detyrimet dhe standardet e furnitorëve) dhe planet apo strategjitë kombëtare. **Për** shembull, ngritja e një sistemi efikas për

<sup>32</sup> Mbështetja me fonde të qeverisë, grante apo kredi me interes të ulët, incentiva për mbulimin e një pjese të investimit (për një kthim më të shpejtë të tij) kryesisht në veshjen e fasadave të jashtme të ndërtesave, paneleve diellore e fotovoltaike, instalimeve në ngrohje/ftohje dhe pajisje elektrike për SME (hoteleri, agroturizëm etj)

shpërndarjen e informacionit ndërmjet aktorëve kryesorë, mundëson dialog efektiv përmes përfaqësuesve të biznesit dhe autoriteteve publike mbi mundësitë e financimit si elementë thelbësorë për të lehtësuar tranzicionin e energjisë për sipërmarrësit e NVM-ve; (iii) **Mbështetjen e auditimeve të energjisë** dhe shërbimeve të këshillimit me synim mbështetjen e NVM-ve me qëllim identifikimin e shpejtë të mundësive për reduktimin e konsumit të tyre të energjisë; (iv) **Zbatimin e rekomandimeve mbi eficientësinë e energjisë që rezultojnë nga auditimet e energjisë, dhe që mund të suportohen edhe me mbështetje financiare.**

### REKOMANDIM 2

Për të lehtësuar aksesin koherent dhe të unifikuar të prodhuesve dhe shfrytëzuesve të energjisë elektrike, në informacionin e nevojshëm në lidhje me promovimin e energjisë së rinovueshme, si dhe adresimin e çështjeve që lidhen me eficientësinë e energjisë, propozohet **zhvillimi i një instrumenti të centralizuar** (p.sh. funksion i një agjencie, platformë, faqe interneti, aplikacion, etj.), **si qendër informacioni që përfshin dhe transmeton edhe praktikën më të mira të menaxhuara nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.** Propozojmë që ky instrument të mund të përfshijë (të paktën):

- » një vështrim të përgjithshëm e transparent mbi programet aktuale të asistencës së ofruar nga donatorët dhe mbështetjen e qeverisë, në fushën e tranzicionit energjetik të NVM-ve dhe mbi çështjet kryesore të ofrimit të kapaciteteve<sup>33</sup>.
- » prezantim i përgjithshëm mbi energjinë e ri-

<sup>33</sup> Në anekse mund të gjeni një informacion më të detajuar mbi instrumentet e financimit i cili mund të detajohet më tej sipas nevojave të NVM.

novueshme dhe eficientësinë e energjisë.

- » baza ligjore në fuqi.
- » kërkesat e dokumentacioni për t'u bërë prodhues dhe blerës i energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme, forma dhe mënyra e aplikimit.
- » mbështetje për investime nga donatorët/institucionet bankare, duke përfshirë dhe pa u kufizuar në produktet financiare të ofruara.
- » identifikimin e subvencioneve të ofruara si dhe mjetet për të përfituar prej tyre.
- » kthimi nga investimi për të gjitha llojet e investimeve.
- » plan biznesi për të gjitha llojet e burimeve të rinovueshme.
- » mbështetje aktive (online) për aplikimet e paraqitura dhe/ose çështje të lidhura me to.

### REKOMANDIM 3

Për të garantuar përfshirjen e NMV-ve në hartimin e planeve të investimit dhe si rrjedhojë, adresimin e çështjeve që lidhen me cilësinë e shërbimit të furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, **MIE/ERE duhet të mundësojnë zbatimin praktik të "Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planeve të investimit nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike", miratuar me vendimin e ERE-s nr. 135, datë 06.09.2017, lidhur me konsultimin e planit të investimit të OST dhe OSSH me palët e interesuara përpara paraqitjes për miratim në ERE.**

## B. NË NIVEL LIGJOR DHE RREGULLATOR:

**Është e nevojshme për të shpejtuar tranzicionin në energji të NVM-ve dhe për të lehtësuar kalimin nga ndërgjegjësimi i thjeshtë në veprime konkrete. Synimi duhet**



*të jetë trendi rritës në treg për investime në burimet e diversifikimit të energjisë nga NVM-të dhe mbështetja e shkallës së madhe të zbatimit të tyre. Rekomandohen ndërhyrje ligjore dhe përmirësime si në legjislacionin primar ashtu edhe në atë sekondar, si dhe në nivel rregullator.*

**Legjislacioni primar**- Sekretariati vlerëson se projektligji i ri “Për nxitjen e përdorimit të burimeve të rinovueshme të energjisë” i cili ka qenë objekt i konsultimit publik, do të miratohet së shpejti. Për një qasje praktike dhe kohezion me dispozitat, rekomandimet e mëposhtme trajtojnë nenet e ligjit aktual në fuqi 7/2017 të cilat mund të miratohen më tej në projektligjin e ri.

#### REKOMANDIM 4

Ndryshimi i nenit 15.3, të ligjit Nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, duke zëvendësuar, në “Skemën e matjes neto të energjisë elektrike”, rezolucionin mujor me atë vjeçar.

#### REKOMANDIM 5

Ndryshimi i ligjit Nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, duke i dhënë mundësinë vetëprodhuesve aktivë në tregun e parregulluar, që energjinë elektrike të prodhuar nga njësitë gjeneruese, ta shesin tek Operatori i Energjiave të Rinovueshme, në bazë të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga vetëprodhuesit aktivë në tregun e parregulluar” që do të miratohet nga Këshilli i Ministrave.

#### REKOMANDIM 6

Ndryshimi i nenit 15.1, të ligjit Nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet

e rinovueshme”, duke rritur kapacitetin total të vetëprodhuesve në 1 MW.

#### REKOMANDIM 7

Ndryshimi i ligjit Nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, duke përfshirë miratimin e parimeve të funksionimit të “Agreguesit” si dhe “Komunitetit të Energjiave të Rinovueshme”.

#### REKOMANDIM 8

Ndryshime në ligjin Nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, duke përcaktuar qartë mundësinë e instalimit të njësisë prodhuese të energjisë elektrike nga vetëprodhuesit në një vend të pavarur nga njësitë e konsumit të energjisë elektrike.

**Legjislacioni sekondar**- Përmirësimet në legjislacionin dytësor dhe/ose zbatimin e dispozitave dhe angazhimeve aktuale të marra në legjislacionin primar, por jo të zbatuara më adoptimin e akteve nënligjore.

#### REKOMANDIM 9

MIE/ Këshilli i Ministrave, në zbatim të nenit 15.3, të ligjit Nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, të miratojë “Metodologjinë e përcaktimit të çmimit të shitjes së tepricave tek Furnizuesi i Shërbimit Universal, i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik”. ERE, në zbatim të nenit 15.3, të ligjit Nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, pas miratimit të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së tepricave tek Furnizuesi i Shërbimit Universal, i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik”, të miratojë çmimin e shitjes së tepricave tek Furnizuesi i Shërbimit Universal.

#### REKOMANDIM 10

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të miratojë Udhëzimin për “Miratimin e procedurës së lehtësuar të autorizimit për lidhjen në sistemin e shpërndarjes të projekteve të vogla të rinovueshme për vetëprodhuesit e energjisë elektrike nga era”.

*Nivel rregullator- rritja e transparencës dhe diversifikimi i produkteve të tregut*

#### REKOMANDIM 11

ERE, në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, Vjenë, të miratojë: (i) procedurën për mundësimin e tregtimit të “certifikatave të gjelbra”; (ii) “Metodologjinë për llogaritjen e detyrimit të energjisë së rinovueshme dhe procedurën për kompensimin e prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike”; (iii) si dhe procedurën për mundësimin e tregtimit të “garancive të origjinës”.

#### REKOMANDIM 12

ERE të miratojë “Treguesit për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2023 (dhe në vijim për çdo vit kalendarik).

#### REKOMANDIM 13

ERE të miratojë, në kuadrin e “Rregullores për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, miratuar nëpërmjet Vendimit të ERE Nr. 181, datë 10.11.2017, “vlerën e kompesimit” të konsumatorëve në rast të mosrespektimit të kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit. Natyra e

*kompesimit të jetë e një penalteti automatik, në përputhje me precedentin e* “Rregullores për kushtet minimale të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes dhe shitjes së energjisë elektrike”, miratuar nëpërmjet Vendimit të ERE Nr. 110, datë 21.10.2011.

#### REKOMANDIM 14

ERE të amendojë “Metodologjinë e Përcaktimit të Çmimeve për Shitjen e Energjisë Elektrike me Pakicë tek Klientët Fundorë që Furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU)”, miratuar nëpërmjet Vendimit të ERE Nr. 189, datë 23.11.2017, duke përcaktuar qartësisht tarifa të veçanta incentivuese për energjinë elektrike të konsumuar në orët e natës/fashat me konsum të ulët.

### C. REKOMANDIME QË SYNOJNË NIXITJEN E SEKTORIT PRIVAT DREJT INVESTIMEVE NË BURIME ALTERNATIVE TË ENERGJISË

#### REKOMANDIM 15

Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë/Shoqatat e Biznesit në bashkëpunim me universitetet dhe qendrat e specializuara të njohurive, duhet të angazhohen në mënyrë proaktive në projekte, evente dhe sesione trajnime që mundësojnë rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetit të biznesit (në fokus NVM-të) për të zgjeruar njohuritë e tyre dhe të përmirësojnë kapacitetet e tyre menaxhuese mbi energjinë lidhur me (i) të dhënat dhe menaxhimin e energjisë (të jenë në gjendje të përpunojnë, menaxhojnë saktë); (ii) zgjidhje inovative për një kulturë qëndrueshmërie që do të plotësonte si prioritetet e kompanisë ashtu edhe palët e interesuara të ndikuara nga biznesi, shembujt/praktikat më të mira; (iii) trajnime për të kuptuar më mirë fak-

torët përcaktues të investimit si vlera e investimit fillestar, periudha e kthimit, siguria e furnizimit me energji, kostoja e energjisë, etj.

#### REKOMANDIM 16

Bankat, promovuesit e skemave mbështetëse dhe institucionet e tjera financiare që japin kredi, duhet të kenë më shumë në fokus promovimin e produkteve inovative në energji dhe forcimin të kapaciteteve të stafit të tyre në nivel lokal.

#### D. SUGJERIME

*Shënim: Çështjet e mëposhtme janë objekt i analizës së mëtejshme siç shtjellohet në Seksionin D të Shtyllës II - Gjetjet dhe Analiza*

- (1) Ndryshimi në nenin 27.3.b) të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, duke përjashtuar zbatimin e “taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja” për të gjitha burimet e rinovueshme të energjisë siç përcaktohet në nenin 3, të ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”.
- (2) Ndryshimi i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 212, datë 20.04.2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. Ligji nr. 92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”, përditëson listën e makinerive dhe pajisjeve që përjashtohen nga TVSH-ja për importet. Lista e makinerive dhe pajisjeve duhet të përfshijë të gjitha burimet e rinovueshme të energjisë, siç përcaktohet në nenin 3 të ligjit

nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”. Përjashtimi nga TVSH-ja do të zbatohet pavarësisht nga vlera e investimit si dhe nga fuqia e instaluar.

- (3) Këshilli i Ministrave, në bashkëpunim me Entin Rregullator të Energjisë, të miratojë akte që mundësojnë furnizimin me energji elektrike me të njëjtat njësi/çmime (duke pasur parasysh tarifën e diferencuara për aksesin në rrjet) për të gjithë klientët e energjisë elektrike të lidhur në tension të mesëm dhe të lartë, përmes Furnizuesit të Mundësisë së Fundit.
- (4) Klima e mirë fiskale është shumë e rëndësishme. Pranojmë që janë bërë përpjekje në drejtim të kuadrit fiskal nga MIE e MFE, por do vlerësonim nëse merret në konsideratë nxitja përmes heqjes së TVSH së importit për paisjet fotovoltaike si paneleve, transformatorëve, inverterave e paisjeve të tjera. (sugjeruar gjatë mbledhjes nga FIAA/Voltalia)
- (5) Burimet alternative konsiderohen me ndërprerje të vazhdueshme nga natyra, pasi nëse era nuk fryn apo dielli nuk del, nuk prodhohet energji, ndaj magazinimi i energjisë është super i rëndësishëm por aktualisht mungon kuadri ligjor mbi magazinimin me bateri të energjisë. (sugjeruar gjatë mbledhjes nga FIAA/Voltalia)
- (6) Lejet e ndërtimit që duhen dhënë nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe procesi është i gjatë e mjaft burokratik aktualisht, sugjerohet që duhet konsideruar për rishikim. (sugjeruar gjatë mbledhjes nga FIAA/Voltalia)

## BIBLIOGRAFIA

1. IRENA- Vlerësimi i Gatishmërisë Për Burimet e Rinovueshme Të Shqipërisë-Mars 2021- <https://www.irena.org/>  
» [/media/Files/IRENA/Agency/Publication/2021/March/IRENA\\_RRA\\_Albania\\_2021.pdf?rev=6b6325eaf5b046329500b961042a265f](https://media/Files/IRENA/Agency/Publication/2021/March/IRENA_RRA_Albania_2021.pdf?rev=6b6325eaf5b046329500b961042a265f)
2. UNECE Factsheet-: Zhvillimi i Energjisë së Rinovueshme në Shqipëri-Qershor 2021  
» [https://unece.org/sites/default/files/2021-07/UNECE-RE\\_Uptake\\_Factsheet\\_Albania.pdf](https://unece.org/sites/default/files/2021-07/UNECE-RE_Uptake_Factsheet_Albania.pdf)
3. Progress Report 2022  
» [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2022\\_en](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2022_en)
4. Udhëzime për Zbatimin e Axhendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor  
» [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2020/10/green\\_agenda\\_for\\_the\\_Western\\_balkans\\_en.pdf](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2020/10/green_agenda_for_the_Western_balkans_en.pdf)  
» <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-05/Albania%20ERP%202022-2024.pdf>
5. Strategjia për Zhvillimin e Biznesit dhe Investimeve  
» <https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2021/10/Strategjia-e-Zhvillimit-t%C3%AB-Biznesit-dhe-Investimeve.pdf>
6. ERP 2023-2025
7. Agjencia për Eficiencën e Energjisë- <http://eficenca.gov.al/informacion/?lang=en>
8. Strategjia Kombëtare e Energjisë 2018-2030- <https://qbz.gov.al/eli/fz/2018/119/43edafea-5386-450b-83c2-f434d0df229c;q=strategjia%20kombetare%20e%20energjisë>
9. Draft Plani Kombëtar të Energjisë dhe Klimës 2021-2030-<https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/422>
10. Ligj Nr.7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”
11. Ligj Nr.116/2016 “Për Performancën e Energjisë së Ndërtimeve”
12. Ligj Nr.124/2015 “Për Eficiencën e Energjisë”
13. Ligj nr. 7-2018, datë 15.2.2018, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”
14. Ligji nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”
15. VKM Nr.480, datë 31.7.2018, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të energjisë për periudhën 2018–2030”
16. VKM Nr. 369, datë 26.4.2017 “Për miratimin

e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”

17. VKM Nr. 852, datë 7.12.2016 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit të funksionimit të Agjencisë për Eficiencën e Energjisë”
18. VKM Nr.27, datë 20.01.2016 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Burimet e Energjisë së Rinovueshme 2015-2020”
19. VKM Nr.619, datë 7.9.2011 “Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për eficiencën e energjisë, 2011-2018”
20. VKM Nr. 38, datë 16.1.2003 “Për miratimin e normave, të rregullave dhe kushteve të projektimit dhe të ndërtimit, të prodhimit dhe ruajtjes së nxehtësisë në ndërtesa”
21. Udhëzim Nr. 3, datë 20.6.2019 “Për miratimin e procedurës së Lehtësuar të autorizimit për Lidhjen në sistemin e Shpërndarjes të projekteve të Vogla të rinovueshme për Vetëprodhuesit e energjisë Elektrike nga dielli”
22. VKM Nr.407, datë 19.06.2019 “Për miratimin e procedurës, të kategorive, kushteve, kërkesave të kualifikimit dhe të eksperiencës profesionale për personin, të cilit i lëshohet certifikata e audituesit energjetik”
23. VKM Nr. 342, datë 22.5.2019 “Për miratimin e kategorive, të kushteve dhe kërkesave të kualifikimit për menaxherin e energjisë”
24. VKM nr. 430, datë 11.7.2018, “Për krijimin e bazës Së të dhënave shtetërore për sistemin elektronik të lejeve (sistemi e-Leje)”
25. Ministria e Infrastruktura dhe Energjisë- <https://www.infrastruktura.gov.al/>

26. Enti Rregullator i Energjisë- <https://www.ere.gov.al/sq/>

27. Agjencia për Eficiencën e Energjisë- <http://eficenca.gov.al/>

28. AIDA

» <https://www.aida.gov.al/sq/>

» <https://www.aida.gov.al/sq/investimet-strategjike/komiteti-i-investimeve-strategjike/vendimet-e-komitetit-te-investimeve-strategjike>

(1) BERZH

» <https://ebrdgeff.com/albania/en/ebrd-geff-dhe-fondi-besa-takojne-koordinatore-t-administratoreve-te-ndertesave-te-banimit-ne-tirane>

» <https://ebrdgeff.com/albania/en/grant-support/>

» <https://ebrdgeff.com/albania/en/Western-balkans-geff-marks-first-disbursement-in-albania/>

» <https://ebrdgeff.com/albania/en/ebrd-lends-e6-million-to-union-bank-to-boost-green-energy-investments-in-albania/>

(2) Bankat Tregtare

» <https://www.procreditbank.com.al/shq/klientet-e-biznesit/kredite/kredi-per-panele-fotovoltaike/>

» <https://www.tiranabank.al/d/818/kredi-per-panele-fotovoltaike>

» <https://www.bkt.com.al/en/need-loan/colateralized-loan/green-loan>

» <https://www.unionbank.al/kredia-per-panele-fotovoltaike/>

» <https://www.otpbank.al/sq/otp-bank-albania-ne-bashkepunim-me-berzh-dhe-be/>

# ANEKSI I

## KUADRI INSTITUCIONAL

### 1. MINISTERIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË (MIE)

- » Përgjegjës për sektorin e energjisë dhe është caktuar për të përgatitur, rishikuar periodikisht dhe përditësuar Strategjinë Kombëtare të Energjisë.
- » Zhvillimi i politikave energjetike dhe strategjive afatmesme dhe afatgjata për sektorin e energjisë; të zhvillojë reformat e tregut në sektor për të përmbushur objektivat kombëtare dhe në përputhje me direktivat e Bashkimit Evropian (BE);
- » Formulimi i kornizës adekuate ligjore; dhe të promovojë eficiencën e energjisë, burimet e ripërtëritshme të energjisë dhe investimet në sektor përmes mjediseve investive të favorshme.

MIE është gjithashtu përgjegjëse për dhënien e të drejtave të autorizimit dhe koncesionit për ndërtimin e termocentraleve në Shqipëri. Koncesionet miratohen nga Këshilli i Ministrave dhe nënshkruhen nga ministri i energjisë në emër të autoritetit kontraktor.

### 2. AGJENCIA E EFIÇIENCËS SË ENERGJISË

- » Institucion i financuar nga shteti që raporton në MIE dhe është përgjegjës për përgatitjen dhe monitorimin e zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Eficiencën e Energ-

jisë, së bashku me monitorimin e zbatimit të programeve të eficiencës së energjisë në sektorët e ndërtesave rezidenciale dhe institucionale, transport, industri, dhe bujqësia.

- » Agjencia gjithashtu ndërmerr auditime energjetike, siguron certifikime për auditorët e energjisë dhe këshillon për përgatitjen e akteve nënligjore që nxisin eficiencën e energjisë.

### 3. ENTIRREGULLATORI ENERGJISË (ERE)

- » Organ i pavarur publik, përgjegjës dhe të cilit përfshijnë rregullimin e aktiviteteve në sektorët e energjisë elektrike dhe gazit natyror, zhvillimin dhe miratimin e rregullave të tregut të energjisë elektrike duke monitoruar gjithashtu të gjitha operacionet e tregut të energjisë elektrike në Shqipëri.
- » ERE lëshon licenca për prodhimin, transmetimin, shpërndarjen, furnizimin dhe tregtimin e energjisë elektrike. Prodhuesit e energjisë elektrike në Shqipëri marrin miratimin e kodeve të rrjetit nga ERE për operimet dhe lidhjet e tyre me rrjetet e transmetimit dhe shpërndarjes.
- » Autoriteti miraton tarifën e energjisë elektrike, duke përfshirë Tarifën Feed-in (FiT), për të gjithë prodhuesit e kualifikuar të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme. ERE përcakton edhe marrëveshjet standarde të blerjes së këtyre prodhuesve.

## ANEKSI II

# GJETJET E VROJTIMIT, BIZNESI DHE ENERGJIA

### OBJEKTI & METODOLOGJIA

#### OBJEKTI I VROJTIMIT

Eksplorimi i mundësive të biznesit drejt investimit në efikasitet në energji dhe përdorimin e burimeve alternative të prodhimit të energjisë


#### METODOLOGJIA

- Pyetësor i strukturuar
- Plotësuar online në mënyrë anonime nga 75 biznese
- Anketa përfshin të dhëna të raportuara gjatë periudhës nëntor 2022 - janar 2023


### SFIDAT E NVM-VE NË KALIMIN DREJT BURIMEVE ALTERNATIVE TË ENERGJISË

#### PROFILI I KAMPIONIT – 75 BIZNESE


##### A jeni biznes eksportues?




##### Madhësia e biznesit tuaj sipas xhiros të vitit të fundit




##### Aktiviteti kryesor ekonomik i biznesit tuaj është




##### Aksionerët/Ortakët më të mëdhenj (me mbi 50% të aksioneve) të biznesit tuaj janë




##### Aksioneri/Ortaku/Pronari më i madh i biznesit tuaj është




##### Cili është numri mesatar i punonjësve në biznesin tuaj?




## Mosha e kompanisë



## Qarku ku kryeni aktivitetin tuaj




## Forma e organizimit të biznesit tuaj




## ENERGJIA - FURNIZIMI DHE KONSUMI

“ **88% e kompanive të anketuara** vlerësojnë ndikimin maksimal që ndërprerja e energjisë ka në zhvillimin normal të aktivitetit të tyre

## Konsumi mesatarisht i energjisë në muaj në kW:



## Sa ndikon në biznesin tuaj ndërprerja e energjisë elektrike?




“ **Vetëm 16%** e kompanive deklarojnë se nuk kanë pasur **asnjëherë ndërprerje** të energjisë elektrike

**Rreth 64%** e të anketuarve deklarojnë ndërprerje deri në **5 herë në muaj**

## EFIÇENCA NË ENERGJI

## A e keni menduar opsionin e investimit në fushën e efiçencës së energjisë?



“


Biznesi ka informacion në lidhje me opsionet e investimit në fushën e efiçencës në energji (9 në 10 kompani), por rreth **64% deklarojnë se koston e larta i kanë ndaluar ata të investojnë**

**22% e tyre deklarojnë se kanë investuar** (50% janë investitore femra), por vetëm 15% janë të kënaqur me rezultatet

Kryesisht **Hoteleri dhe Industri përpunuese**


## SFIDAT E NVM-VE NË KALIMIN DREJT BURIMEVE ALTERNATIVE TË ENERGJISË

## A keni pasur ndërprerje të energjisë elektrike, mesatarisht në muaj?



## BURIME ALTERNATIVE

## A e keni menduar opsionin e investimit në burime alternative të prodhimit të energjisë, panele diellore, era, biomasa etj?



“


Biznesi ka informacion në lidhje me opsionet e investimit në burime alternative të prodhimit (në 95% të tyre) të energjisë, por rreth **64% e tyre deklarojnë se koston e larta i kanë ndaluar ata të investojnë**

25% e tyre deklarojnë se kanë investuar (37% janë investitore femra), **por vetëm 17% janë të kënaqur me rezultatet**


Kryesisht **Hoteleri dhe Industri përpunuese**

## FAKTORËT PËRCAKTUES


Sa do të ndikonte **vlera e investimit fillestar** në vendimin tuaj për të investuar në efikasitetin e energjisë dhe/ose burimet alternative të prodhimit të energjisë?




Sa do të ndikonte **afati i kthimit nga investimi** në vendimin tuaj për të investuar në efikasitetin e energjisë dhe/ose burimet alternative të prodhimit të energjisë?



Sa do të ndikonte **rritja e sigurisë me furnizimin me energji** në vendimin tuaj për të investuar në efikasitetin e energjisë dhe/ose burimet alternative të prodhimit të energjisë?




Sa do të ndikonte **ulja e kostove të energjisë** në vendimin tuaj për të investuar në efikasitetin e energjisë dhe/ose burimet alternative të prodhimit të energjisë?



Në vendimin e kompanive për investim në efikasitetin/prodhim energjisë duket se **ulja e kostove dhe rritja e sigurisë së furnizimit me energji** janë faktorët determinant

Për sipërmarrëset femra, faktorët më determinant janë ulja e kostove dhe vlera e investimit fillestar


Cili nga faktorët do të ndikonte më shumë në vendimin tuaj për **të investuar në efikasitetin e energjisë** dhe/ose burimet alternative të prodhimit të energjisë?




## SFIDAT E NVM-VE NË KALIMIN DREJT BURIMEVE ALTERNATIVE TË ENERGJISË

## BURIME FINANCI MI


Sa të familjarizuar jeni mbi format e financimit të investimit në fushën e efikasitetit të energjisë dhe/ose burimeve alternative të prodhimit të energjisë nga **Donatorët**




Sa të familjarizuar jeni mbi format e financimit të investimit në fushën e efikasitetit të energjisë dhe/ose burimeve alternative të prodhimit të energjisë nga **Bankat**



Sa të familjarizuar jeni mbi format e financimit të investimit në fushën e efikasitetit të energjisë dhe/ose burimeve alternative të prodhimit të energjisë nga **Institucionet e tjera financiare jobanka**




Sa të familjarizuar jeni mbi format e financimit të investimit në fushën e efikasitetit të energjisë dhe/ose burimeve alternative të prodhimit të energjisë nga **Institucionet shtetërore**



Bankat janë institucionet më të shfrytëzuara nga bizneset në lidhje me investimet në efikasitetin / prodhim energjie, e njëjta sjellje vëhet pavarësisht gjinisë së sipërmarrësit.

Me kë jeni më të familjarizuar mbi format e financimit të investimit në fushën e efikasitetit të energjisë dhe/ose burimeve alternative të prodhimit të energjisë?



## KONKLUZIONE

Sipërmarrja **është e informuar** në lidhje me mundësitë e investimit në **efiçencë energjie** apo **burime aternative të prodhimit të energjisë**, në kushtet e krizës globale të energjisë si edhe planet e qeverisë për liberalizimin e tregut të energjisë.

Biznesi **vuan nga ndërprerjet e vazhdueshme të energjisë elektrike**, të cilat shkaktojnë problematika në aktivitetin e biznesit të tyre.

**Kostot e larta** përgjithësisht kanë “penguar” biznesin në marrjen e vendimit të investimit në efiçencë energjie dhe burime alternative të prodhimit të energjisë.

Hoteleria dhe Industria përpunuese kryesisht kanë investuar edhe pse një pjesë konsiderojnë investimin si jo efiçent.

**Ulja e kostove të energjisë dhe rritja e sigurisë në furnizim me energji** janë faktorët vendimtarë që do të ndikonin në marrjen e vendimit të investimit në efiçencë/burime alternative të prodhimit të energjisë; kurse koha e kthimit të investimit është faktori që do të kishte ndikimin më të ulët në marrjen e këtij vendimi.

**Bankat** janë institucioni më familjar në lidhje me mundësitë për investime në fushën e energjisë.

## ANEKSI III

### ANALIZË MBI LIÇENCIMIN PËR BURIMET ALTERNATIVE

#### A. LIÇENCIMI PËR BURIMET ALTERNATIVE (VETËPRODHUESIT)

**V**etëprodhuesi i energjisë elektrike, bazuar në ligjin Nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, konsiderohet një shoqëri e vogël ose e mesme, i cili mund të instalojë një kapacitet total deri në 500 kw për prodhimin e energjisë elektrike nga era ose dielli. Ky kapacitet ka për qëllim të injektojë energjinë e tepërt në rrjetin e shpërndarjes, bazuar në skemën e matjes neto të energjisë elektrike të prodhuar dhe konsumuar, e përlogaritur me bazë mujore. Vetëprodhuesit e energjisë elektrike, bazuar në nenin 37.6.b dhe 49.4, të ligjit Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nuk i nënshtrohen procedurave të licencimit nga Enti Rregullator i Energjisë si dhe rregullave dhe procedurave për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese të cilat nuk janë objekt koncesioni. Në nenet 15.1 dhe 15.4, të ligjit Nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, përcaktohet:

- 15.1. Në përputhje me skemën e matjes, një shoqëri e vogël ose e mesme mund të instalojë një kapacitet total deri në 500 kw për prodhimin e energjisë elektrike nga era ose dielli për të mbuluar një pjesë ose të gjithë energjinë që nevojitet për nevojat e tij dhe të injektojë energjinë e tepërt të prodhuar në rrjetin e shpërndarjes.
- 15.4. Ministri miraton me udhëzim një procedurë të lehtësuar për autorizimin për lidhjen në sistemin e shpërndarjes të **projekteve të vogla të energjisë së rinovueshme**.

Nga një analizë e bazës ligjore të aplikueshme, rezulton që legjislacioni primar, qartësisht e ka klasifikuar prodhimin e energjisë elektrike nga era, si prodhim objekt i skemës neto të matjes së energjisë elektrike (neni 15.1), duke autorizuar ministrin përgjegjës për energjinë për miratimin e procedurës së lehtësuar për autorizimin për lidhjen në sistemin e shpërndarjes të projekteve të prodhimit të energjisë elektrike nga era.

## B. Lidhja e vetëprodhuesve me rrjetin

Vetëprodhuesit lidhen me sistemin elektroenergjitik duke ju nënshtruar procedurave të para-shikuara në Udhëzimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 3, datë 20.06.2019 “Për miratimin e procedurës së lehtësuar të autorizimit për lidhjen në sistemin e shpërndarjes të projekteve të vogla të rinovueshme për vetëprodhuesit e energjisë elektrike nga dielli”. Bazuar në këtë Udhëzim, vetëprodhuesit, për t’u lidhur me sistemin elektroenergjitik, duhet të paraqesin:

- *Lista e dokumentave për aplikim në bashki për impiant fotovoltaik:*

- » Certifikatë pronësie dhe kartelë e rifreskuar e 3 muajve të fundit (në rast qiramarrjeje, konsensus i qiradhënësit/pronarit);
- » Planimetri e çatisë, tarracës apo e tokës ku do të vendosen panelet;
- » ID e aplikuesit, ekstrakt i QKB dhe ID e administratorit;
- » Planvendosja e impiantit, projekti dhe foto e gjendjes aktuale e pronës;
- » Projekt elektrik, preventiv dhe grafik punimesh.

- *Lista e dokumentave për aplikim në OSSH për impiant fotovoltaik:*

- » Plotësimi i formularit të aplikimit “Për skemën e matjes neto”;

- » Deklaratë e konsumit mesatar vjeçar të dy viteve të fundit ose, në rast të mungesës së historikut, raporti i audituesit energjitik si dhe propozimi për fuqinë e instaluar;
- » Projekti i miratuar për lidhjen e impiantit PV me rrjetin e shpërndarjes;
- » Propozim mbi modelin e matësit me dy drejtime (skema e matjes neto), të dhëna mbi inverterin kryesor dhe karakteristikat e matësit të vendosur pas tij;
- » Relacion teknik;
- » Licenca e inxhinierit projektues;
- » Leje nga Bashkia “Punime që kryhen me deklaratë paraprake punimesh”;
- » Numri i kontratës ekzistuese pa detyrime të pashlyera.

Aplikimi trajtohet brenda 30 ditësh pune nga data e aplikimit. Aplikuesi, në rastin e miratimit, ka afat 6 muaj për të ndërtuar impiantin fotovoltaik. OSSH mund të shkëpusë impiantin nga sistemi energjitik në rast se vërteton që prodhimi tejkalon konsumin e energjisë elektrike në një vit të caktuar kalendarik.

Deri në miratimin e “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së tepricave tek Furnizuesi i Shërbimit Universal, i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik”, teprica mujore i kalon Furnizuesit të Shërbimit Universal pa kundërshpërblim.

## ANEKSI IV

### INSTRUMENTA FINANCIARË NË DISPOZICION TË SEKTORIT PRIVAT MBI ENERGJINË

**F**inancimi i biznesit në fushën e energjisë sa vjen dhe ka një rritje të ndjeshme, kjo për faktin edhe të situatës së krijuar vitin e fundit nga konflikti Rusi-Ukrainë. BE-ja ka qënë një ndër financuesit kryesor në këtë drejtim. BE ka mbështetur për shumë vite një treg energjie më të lidhur dhe më të pastër në Ballkanin Perëndimor. Midis 2015 dhe 2020, BE-ja dha 1 miliard euro grante për projektet e energjisë dhe transportit të kanalizuar përmes **Western Balkans Investment Framework (WBIF)**<sup>34</sup> – një platformë investimi donatorësh që grumbullon fonde nga burime të ndryshme, duke përfshirë Komisionin Evropian. Kjo solli rezultate të prekshme – mbi 650 km tubacione gazi që lidhin rajonin me vendet fqinje të BE-së, rrjete të modernizuara të ngrohjes qendrore, linja të përmirësuara të transmetimit të energjisë elektrike dhe shumë më tepër.

BE-ja është gjithashtu shumë aktive në

mbështetjen e reformave rregullatore dhe politikave për ta sjellë rajonin më afër tregut të brendshëm të energjisë të BE-së. Që nga viti 2006, Komuniteti i Energjisë – duke bashkuar BE-në dhe fqinjët e saj – ka punuar për të krijuar një klimë më të mirë për tërheqjen e investimeve në prodhimin e energjisë dhe rrjetet.<sup>35</sup>

**WBIF** është një platformë që mbështet zhvillimin socio-ekonomik dhe anëtarësimin në BE në të gjithë Ballkanin Perëndimor përmes ofrimit të financave dhe asistencës teknike për investimet strategjike në **sektorët e energjisë**, mjedisit, social, transportit dhe infrastrukturës dixhitale, si dhe mbështet iniciativat e zhvillimit të sektorit privat. Është një nismë e përbashkët e BE-së, institucioneve financiare, donatorëve dypalësh dhe qeverive të Ballkanit Perëndimor. WBIF, bazuar në procedurat konkurruese, jep grante për aktivitetet e përgatitjes së projekteve të infrastrukturës si dhe për investime. Thirrjet për propozime nisen nga Komiteti

<sup>34</sup> Lista e projekteve të cilat mund të filtrohen sipas vendit përfitues, sektorit, statusit, liderit: <https://www.wbif.eu/wbif-projects>

<sup>35</sup> <https://webalkans.eu/en/themes/connectivity/energy/>



Drejtuës i WBIF. Në përgjithësi, ka dy thirrje për asistencë teknike dhe vetëm një thirrje për grante investimi në vit. Udhëzimet publikohen për çdo thirrje për propozime që përcaktojnë kriteret e përshtatshmërisë, duke përfshirë çdo kërkesë specifike, si dhe afatet e para-njoftimit dhe dorëzimit. Aplikimet vlerësohen nga Grupi i Financuesve të Projekteve të WBIF, i cili rekomandon aplikimet e përzgjedhura për miratim në Komitetin Drejtues. Grantet e miratuara më pas zbatohen nga ekipet e Facilitetit të Projektit të Infrastrukturës dhe/ose vetë (IFIs). WBIF financon përgatitjen dhe zbatimin e projekteve prioritare të infrastrukturës përmes:

- » granteve nga Instrumenti i Komisionit Evropian për Asistencën e Para-Aderimit (IPA) dhe 20 donatorë bilateral;
- » me kredi nga institucionet financiare pjesëmarrëse;
- » financave kombëtare.

Në fillim, CEB, EBRD dhe EIB kontribuan në aktivitetet e granteve të WBIF.

Që nga viti 2009, WBIF ka mbështetur 43 projekte për 3.2 miliardë euro investime të vlerësuara në sektorin publik në Shqipëri. Vendi ka përfituar nga 61 grante për 345.9 milionë euro në asistencë teknike dhe bashkëfinancim investimesh. Mbështetja e grantit IPA të BE-së e kanalizuar përmes WBIF llogaritet në 326.8 milionë euro dhe mbulon si asistencën teknike (€52.8m) ashtu edhe grantet investuese (€293.1m). Edhe donatorët tjerë kanë kontribuar me 19.1 milionë euro.<sup>36</sup>

Për periudhën 2009- 2021, me të dhënat e Shtatorit 2021, grantet e WBIF për Shqipërinë specifikisht në sektorin e energjisë kapin vlerën 30.4 milionë euro.<sup>37</sup>

36 <https://www.wbif.eu/beneficiaries/albania>

37 <https://wbif.eu/storage/app/media/Library/FactSheets/ALB/WBIF%20Country%20Summary%20Albania%20ENG.pdf>

**Western Balkans Enterprise Development & Innovation Facility (WB EDIF)** fillimisht filloi të ofrojë financim për Shqipërinë nëpërmjet instrumentit të saj të Lehtësimit të Garancisë, i cili u vendos nëpërmjet **Procredit Bank**. Pas vendosjes së mirë të këtij raundi të parë financimi, u nënshkrua një Lehtësim i dytë Garancie me **Raiffeisen Bank Albania**.<sup>38</sup> 666 SME janë mbështetur në Shqipëri nga WB EIDF.<sup>39</sup>

Si pjesë e WBIF, **Regional Energy Efficiency Programme (REEP)**, mbështet SME-të, bashkitë, familjet dhe qytetarët në reduktimin e konsumit të energjisë, duke kontribuar në rritjen ekonomike rajonale. REEP është krijuar në 2012 dhe përfshin më shumë se 600 milionë euro investime nga BERZH dhe Grupi Bankar KfW, të cilat kombinohen me grante nga WBIF. Organizata të ndryshme bashkëpunojnë për ta bërë atë një sukses, duke përfshirë Komunitetin e Energjisë, EBRD, Komisionin Evropian dhe Grupin Bankar KfW.<sup>40</sup>

**Green for Growth Fund (GGF)** ndihmon bizneset dhe familjet të zbusin ndryshimet klimatike duke reduktuar konsumin e energjisë, përdorimin e burimeve dhe emetimet e CO<sub>2</sub>. Sipas të dhënave të përditësuara deri në 30.06.2022, GGF në Shqipëri ka vetëm një institucion partner, që është institucion financiar, konkretisht BKT. Vlera e investuar është 25.0 milionë euro. Numri i projekteve ku GGF ka ofruar mbështetje teknike për Shqipërinë është 73 (5% e totalit), duke arritur vlerën e 1.3 milionë euro (6% e totalit)<sup>41</sup>.

38 <http://www.wbedif.eu/wbedif-in-your-country/albania/#map>

39 <https://www.wbif.eu/beneficiaries/albania>

40 <https://www.wbif.eu/reep>

41 Shënim: \* Meqenëse disa nga projektet janë zhvilluar në disa vende, shuma e numrit total të projekteve tejkalon numrin total të projekteve.

The Green Economy Financing Facility (GEFF) është një strukturë e zhvilluar nga EBRD që ofron një linjë kredie prej 85 milionë euro për bankat pjesëmarrëse në Ballkanin Perëndimor për huadhënie për bizneset e kualifikuara që dëshirojnë të investojnë në projektet e ekonomisë së gjelbër. Ekipi lokal i zbatimit të GEFF ofron mbështetje në faza të ndryshme të vlerësimit dhe zbatimit të investimeve. Kjo mund të përfshijë vlerësime të projekteve, trajnime, marketing dhe mbështetje për fillimin e projektit për të ndihmuar përfituesit të identifikojnë zgjidhjet më të mira dhe të përgatisin një projekt të suksesshëm të ekonomisë së gjelbër.

Shërbimet këshilluese të GEFF financohen nga BE, WBIF dhe Republika e Austrisë<sup>42</sup>, dhe kapin një linjë kredie prej 3 milionë eurosh duke ndihmuar familjet të investojnë në teknologji me performancë të lartë duke siguruar financim nëpërmjet Institucioneve Financiare Pjesëmarrëse vendase, konkretisht ProCredit Bank dhe Union Bank. (Financimi i nënshtrohet aftësisë kreditore të zakonshme dhe kriterëve të tjera të financimit të secilit Institucion Financiar Pjesëmarrës)<sup>43</sup>.

Më 03.05.2019, GEFF dhe Fondi Besa ndërmorën një fushatë me disa prej administratorëve të palateve në ambientet e Bashkisë Tiranë për t'u prezantuar atyre mundësinë e marrjes hua si dhe mënyrën për të përftuar nga kjo hua për investime<sup>44</sup> në vlerën 1.5 milionë euro nga 3.0 milionë euro të dedikuara nga GEFF<sup>45</sup> për Shqipërinë.<sup>46</sup>

42 <https://ebrdgeff.com/albania/en/> <https://ebrdgeff.com/albania/en/the-programme/>

43 <https://ebrdgeff.com/albania/en/the-programme/stakeholders/>

44 <https://ebrdgeff.com/albania/en/ebrd-geff-dhe-fondi-besa-takojne-koordinatorete-e-administratoreve-te-ndertesave-te-banimit-ne-tirane/>

45 <https://ebrdgeff.com/albania/en/grant-support/>

46 <https://ebrdgeff.com/albania/en/western-balkans-geff-marks->

EBRD i jep 6 milionë euro kredi Union Bank Albania për rritjen e efikasitetit të energjisë si mbështetje të investimeve në projekte të efikasitetit të energjisë me performancë të lartë në banesa ose ndërtesa rezidenciale në pronësi private.<sup>47</sup>

**The European Fund for Southeast Europe (EFSE)** është një fond ndikimi që merr një qasje gjithëpërfshirëse për të nxitur zhvillimin ekonomik dhe prosperitetin në Evropën Juglindore dhe Rajonin e Fqinjësisë Lindore të BE-së. Duke investuar në infrastrukturën financiare lokale që ofron financim të dedikuar për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, fondi mbështet shtyllën kurrizore të ekonomisë së këtyre rajoneve. Për më tepër, EFSE ndihmon në krijimin e kushteve që bizneset vendase të lulëzojnë duke ndërtuar kapacitetet e institucioneve financiare lokale ose duke lehtësuar ndarjen e njohurive përmes Mjetit të Zhvillimit dhe duke ofruar trajnime dhe mentorim në terren nëpërmjet Akademisë së Sipërmarrjes. Në këtë mënyrë, fondi synon të arrijë ndikim si në nivel individual ashtu edhe në atë sistematik.

Përsa i përket Shqipërisë, vlen të theksohet se është vetëm një partner "FED Invest" me një vëllim kumulativ i nënkredive që nga fillimi me vlerën 120,342,847 euro dhe me një numër të huamarrësve aktivë përfundimtarë në 537. Ndërkohë që vëllimi i projektit të Facilitetit Zhvillimor kap vlerën e 3,347,072 euro<sup>48</sup>. Vlen të theksohet se 9.4% e projekteve totale të EFSE për mbështetje teknike që nga fillimi i Instrumentit të Zhvillimit EFSE në

[first-disbursement-in-albania/](https://ebrdgeff.com/albania/en/ebrd-lends-e6-million-to-union-bank-to-boost-green-energy-investments-in-albania/)

47 <https://ebrdgeff.com/albania/en/ebrd-lends-e6-million-to-union-bank-to-boost-green-energy-investments-in-albania/>

48 <https://www.efse.lu/>

2006 deri më 31 dhjetor 2021 kanë qenë për Shqipërinë.<sup>49</sup>

**Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ)** është një tjetër institucion i cili ka patur një fokus të madh në sektorin e energjisë. Në Shqipëri ka qenë e fokusuar në dy çështje parësore:

- » Zhvillimi i Qëndrueshëm Ekonomik, formimi profesional dhe promovimi i punës;
- » Klima, Energjia dhe Tranzicioni, përfshirë Zhvillimin e Qëndrueshëm Urban.

Energjia ka qenë çështja kryesore në fund të vitit të shkuar dhe këtë vit, duke e vënë theksin te burimet e rinovueshme. Në sektorin e energjisë, kontributi më i madh në infrastrukturë bëhet nëpërmjet **Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW)**. GIZ ka shumë projekte që lidhen me eficiencën e energjisë.

GIZ ka mbështetur qeverinë qendrore dhe lokale për të rritur kapacitetet dhe për të ofruar më shumë mjete për monitorimin e kursimit të energjisë dhe verifikimit në nivel kombëtar. Ky projekt mbështeti në një shkallë mikro sistemet fotovoltaike në zonat e largëta dhe jashtë rrjetit, për të siguruar nevojat bazë për ndriçim dhe energji elektrike.

GIZ po mbështet bashkitë për të planifikuar për vitin **2030**, në formën e **Planit të Veprimit për Energji të Qëndrueshme dhe Klimën**. Këto plane do t'u mundësojnë një rrugë të pastër bashkive për të arritur objektivin e tyre të klimës, një pjesë e rëndësishme e të cilave është zgjerimi në Burimet e Rinovueshme të Energjisë. GIZ mundëson ekspertizën më të mirë në hartimin e planeve dhe mbështet bashkitë gjatë zbatimit edhe nëpërmjet projekteve pilot.

49 [https://www.efse.lu/fileadmin/user\\_upload/efse/7\\_publications/publications\\_dateien/sektion\\_3\\_-\\_publications/impact\\_reports/EFSE\\_Impact\\_Report\\_Digital\\_2022.pdf](https://www.efse.lu/fileadmin/user_upload/efse/7_publications/publications_dateien/sektion_3_-_publications/impact_reports/EFSE_Impact_Report_Digital_2022.pdf)

Sipas GIZ, vetëprodhimi, si skemë në Shqipëri, është një zhvillim ende i ri dhe edhe pse kuadri rregullator nuk është plotësisht i adoptuar, ka pasur një rritje të interesit nga institucionet publike dhe private për të investuar, veçanërisht në kohën kur sapo nisi kriza e energjisë.<sup>50</sup>

**Programi Gratë në Biznes**, me mbështetjen e **EBRD** siguron financim pranë bankave lokale përmes linjave të kredisë të dedikuara për NVM-të të drejtuara nga gratë, së bashku me konsulencë rreth biznesit për t'i ndihmuar ato të bëhen më konkurruese, si dhe ofron trajnime, këshillime dhe mbështetje të tjera për t'i mundësuar grave drejtuese të shkëmbejnë përvojat dhe të mësojnë nga njëra-tjetra si kolege.

Në 2019, nëpërmjet bankave të nivelit të dytë, filloi kreditimi në një linjë prej 5 milionë eurosh për Shqipërinë nën Programin II të Grave në Biznes për Ballkanin Perëndimor të EBRD, i cili pason një lehtësi prej 2 milionë eurosh nga viti 2015, të shfrytëzuar plotësisht.<sup>51</sup>

**International Finance Corporation (IFC)** po asiston investitorët e mundshëm në vlerësimin, strukturimin dhe zbatimin e projekteve në Shqipëri dhe në dhënien e kredive dhe investimeve në kapital, duke përfshirë financimin nga burime të tjera.

IFC po rrit përfshirjen e saj në Shqipëri për:

- » Të rritur mbështetjen e sektorit financiar;
- » Të kërkuar mundësi për të financuar investimet e sektorit privat në infrastrukturë dhe për të ndërmarrë financime selektive të investimeve të infrastrukturës kritike;
- » Të ofruar asistencë financiare dhe teknike

50 <https://www.monitor.al/shqiperia-potencial-per-rritje-nga-agroturizmi-tek-energja-2/>

51 <https://www.ebrd.com/news/2019/boosting-access-to-finance-for-women-led-small-businesses-in-albania.html>

- për SME-të në fazën e pas privatizimit;
- » Rehabilitimin e sektorëve kryesorë industrialë si nafta dhe gazi, minierat dhe industrinë e ngjashme, dhe materialet e ndërtimit;
- » Mbështetjen e zhvillimit të sektorëve të ndryshëm ku Shqipëria ka avantazhe krahasuese si prodhimi i lehtë, peshkimi dhe turizmi.<sup>52</sup>

Me kërkesën e Qeverisë së Shqipërisë për të rritur peshën e energjisë termike diellore në vend, **UNDP** dhe **GEF** mbështesin teknologjinë e ngrohjes diellore të ujit përmes instrumenteve ligjore dhe të bazuara në treg. UNDP ka bashkëpunuar me **Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë** dhe **Ministrinë e Mjedisit** për këtë qëllim.

Ideja fillestare e projektit erdhi nga **Strategjia Kombëtare e Energjisë** dhe studimet e mëparshme të ndryshimeve klimatike si Vlerësimi i Parë Kombëtar i Komunikimit dhe Nevojave Teknologjike të Shqipërisë, të cilat promovojnë dhe rekomandojnë Ngrahjen Diellore të Ujit (SËH) si një nga teknologjitë premtuese për të reduktuar energjinë elektrike dhe konsumin e drurit për lëndë djegëse me një kontribut të rëndësishëm në reduktimin e emetimeve të gazeve serrë.<sup>53</sup>

**Nisma nga institucionet shtetërore në vend** - Përveç mundësive të përmendura më sipër ka edhe disa të tjera të cilat janë iniciuar nga institucione shtetërore të cilat kanë si qëllim stimulimin e këtyre investimeve në sektorë specifik.

Ndër këto iniciativa mund të përmendim “Skemën Kombëtare” për mbështetje financiare për bujqësinë dhe zhvillimin rural nga buxheti i Qeverisë Shqiptare. Fondi i miratuar në buxhetin

52 [http://web.worldbank.org/archive/website01337/WEB/0\\_CO-22.HTM.tmp](http://web.worldbank.org/archive/website01337/WEB/0_CO-22.HTM.tmp)

53 <https://www.undp.org/albania/projects/country-program-albania-under-global-solar-water-heating-market-transformation-and-strengthening-initiative>

e vitit 2020 për *Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural*, zëri “Transfertë në buxhetet familjare”, do të përdoret për rritjen e konkurrueshmërisë së prodhimeve blegtorale, të prodhimeve bujqësore në mjedise të mbrojtura dhe uljen e kostove të prodhimit. Kjo skemë është vënë në zbatim nga *Agjencia e Zhvillimit Bujqësor Rural – AZHBR*

### Aksesi në fonde financimi të sektorit financiar

Aktualisht shumica e bankave në vend kanë përfshirë paketa specifike për kredi në fushën e energjisë për bizneset por që janë në nivele shumë të ulëta apo të pa përfillshme. Për të bërë të mundur një analizë të situatës aktuale u kontaktuan të gjitha bankat dhe në raste kur figuronin programe të tilla u bënë edhe takime me përfaqësues të drejtorive përkatëse në banka për të kuptuar më tepër situatën. Ndër bankat e përfshira në dhënie kredish për sistemet fotovoltaike mund të përmendim:

- » Intesa Sanpaolo Bank – është një nga bankat që gjatë viteve të fundit ka qenë shumë aktive në drejtim të kredive për investime në panelet fotovoltaike. Gjatë vitit 2022 janë disbursuar 42 projekte me një vlerë prej 8.8 milion euro, janë në proces 13 të tjera me një vlerë prej 3.3 milion euro dhe janë refuzuar 13 të tjera me një vlerë me 2.6 milion euro. Ndërkohë që gjatë vitit 2021 janë disbursuar vetëm 22 projekte me një vlerë prej 4 milion. Të gjitha këto projekte janë dhënë për biznese private.
- » Procredit Bank<sup>54</sup> – është gjithashtu aktive në energjinë e rinovueshme. Më konkretisht disa nga iniciativat më konkrete janë të lidhura me:

54 <https://www.procreditbank.com.al/shq/klientet-e-biznesit/kredite/kredi-per-panelet-fotovoltaike/>

- o krijimin e stacioneve elektrike - në këtë kuadër janë krijuar 26 stacione elektrike.
- o investime në panele fotovoltaike ku aktualisht janë 139 projekte të mbështetura me një kapacitet prej 38 MË. Kreditë e dhëna për këto investime kanë një afat maksimal prej 7 vjetësh me 100 % të vlerës së financimit. Për më tepër në këtë kuadër ka edhe një marrëveshje me BERZH nga e cila janë 50 milion euro në sektorin e turizmit dhe agrobiznesit dhe 3 milion euro për SME ku janë të përfshira edhe investimet në panelet fotovoltaike.

- » Tirana Bank<sup>55</sup> – i ka dhënë fokus të drejt-përdrejtë në kreditimin e për panele fotovoltaike. Investimi mbulohet në 100% të vlerës me një vlerë maksimale deri në 150 mijë euro dhe afat maturimi 5 vjeçar.
- » Banka Kombëtare Tregtare<sup>56</sup> – ka kredi specifike për eficientë në energji për individët dhe bizneset.
- » Unionbank<sup>57</sup> – gjithashtu jep kredi për panele fotovoltaike. Investimi mbulohet në 100% të vlerës me një vlerë maksimale deri në 500 mijë euro dhe afat maturimi deri në 7 vjet. Kapaciteti i paneleve për përdorim vetjak është maksimumi deri në 500këp (*kilovat "peak"*).

Në kuadër të kësaj kredia banka ofron edhe kontratën e shitblerjes, ofertën financiare dhe ofertën me specifikimet teknike së bashku me garancinë e sistemit si dhe konsulencën për kapacitetin e panelit dhe mirëmbajtjen për sistemin.

55 <https://www.tiranabank.al/d/818/kredi-per-panelet-fotovoltaike>

56 <https://www.bkt.com.al/en/need-loan/collateralized-loan/green-loan>

57 <https://www.unionbank.al/kredia-per-panelet-fotovoltaike/>

OTP Bank Albania<sup>58</sup> - në bashkëpunim me BERZH dhe BE ka filluar së fundmi një program të ri në mbështetje të SME-ve që ofron hua nga BERZH dhe grante nga BE. SME-të ndër të tjera mund të aplikojnë për investime me qëllim rritjen e eficientë së energjisë dhe përafrimin me standardet e BE. Krahas huave, bizneset do të përfitojnë nga incentiva në formë granti deri në 15 përqind të huas, të financuara nga BE.

Përveç bankave ka edhe institucione të tjera financiare të cilat janë të përfshira në këtë sektor ku mund të përmendet Lutecredit, Fond Besa, etj.

#### Evidentimi i programeve mbështetëse nëpërmjet granteve në BE

Bashkimi Evropian gjithmonë e më tepër po vendos fokusin në sektorin e energjisë dhe mbrojtjes së mjedisit. Më konkretisht BE është duke implementuar "Energy and the Green Deal" i cili kap një vlerë me rreth 600 miliard euro për periudhën 7 vjeçare.<sup>59</sup>

Gjithashtu në kuadër të Programit Horizont Europe 2021-2027 ka një kategori specifike me fokus energjinë "Cluster 5: Climate, Energy and Mobility", ku mund të aplikojnë për fonde institucione edhe nga Shqipëria. Këto thirrje janë një mundësi shumë e mirë për të ndërtuar edhe urat e bashkëpunimit mes aktorëve privat, një-sive shtetërore dhe akademisë. Aktualisht janë të hapura një sërë thirrjesh për grante nën këtë Cluster të cilat janë një mundësi shumë e mirë për të ndërmarrë iniciativa të përbashkëta mes grupeve të interesit.

58 <https://www.otpbank.al/sq/otp-bank-albania-ne-bashkepunit-me-berzh-dhe-be/>

59 [https://ec.europa.eu/info/strategy/priorities-2019-2024/european-green-deal/energy-and-green-deal\\_en](https://ec.europa.eu/info/strategy/priorities-2019-2024/european-green-deal/energy-and-green-deal_en)

## ANEKSI V

### ANALIZË MBI KTHIMIN NË KOHË TË INVESTIMIT

Vlerësimi i kthimit të investimit në sektorin energjetik është i rregulluar dhe varion sipas qarqeve. Në tabelën 1 jepet informacion i detajuar për tre qarqe në vend. Është përzgjedhur Tirana për shkak të numrit të lartë të bizneseve dhe si një qark që është në mesataren e nivelit të rrezatimit në vend ndërsa Shkodra dhe Fieri janë përzgjedhur për shkak të dy ekstremeve të rrezatimit diellor, Shkodra me nivelin e rrezatimit më të ulët dhe Fieri me nivelin e Rrezatimit më të lartë në vend. Vlerësimet janë bërë për disa fasha të energjisë duke specifikuar edhe nivelin e investimit të nevojshëm. Duke qenë se shumica e bankave e japin kredinë për panelet fotovoltaike deri në 7 vjet, kjo periudhë është marrë për të bërë vlerësimin e kështit të kredisë ndërkohë që si normë interesi është marrë niveli 7 % sipas kushteve të bankave të cilat ofrojnë kredi. Në bazë të këtij informacioni është vlerësuar kështit mujor dhe

vlera totale e kredisë e cila mund të krahasohet me vlerën e faturave të energjisë që paguajnë bizneset aktualisht. Në skenarin 2 është dhënë pikërisht informacion mbi pagesën aktuale që bëjnë bizneset sipas fashës përkatëse për energji elektrike si dhe është vlerësuar vlera totale dhe periudha që do iu duhej nëse do merrnin kredi në këto kushte.

Nga tabela 1, referuar rastit të qarkut të Tiranës, duket që bizneset që konsumojnë më pak se 2000 kwh/vit janë të disfavorizuar nga investimet në panelet fotovoltaike pasi kështit i kredisë është më i lartë sesa pagesa mujore që bëjnë bizneset. Nga ana tjetër bizneset që janë nga 2000 deri në 5000 kwh/vit janë pothuajse në nivel të barabartë të pagesës së kështit të kredisë me atë të pagesës së faturës së energjisë elektrike dhe për të gjithë bizneset që konsumojnë më shumë se 6000 kwh/vit ka një interes shumë të madh që bizneset të përfshihen në investime për panelet fotovoltaike.

E njëjta analizë mund të bëhet edhe për dy qarqet e tjera, si qarqe me të dhëna ekstreme në vend, dhe për gjithë qarqet e tjerë që bien brenda këtyre intervaleve. Informacion më i detajuar për kategoritë e konsumatorëve sipas fashave jepet në tabelën 2.

**Tabela 1. Financimi i investimeve në energji, skenarë**

TIRANE	Fashat e energjisë (kwh/vit)	Fuqia e instaluar	Investimi	SKENARI 1 - Afat shlyerje për 7 vite			SKENARI 2 - sipas faturës së energjisë		
				Kësti	Pagesa e plotë	Vitet e shlyerjes	Kësti	Pagesa e plotë	Vitet e shlyerjes
				0-1000	8	(1,380,000)	20,828	1,749,543	7 vite
2000-5000	41	(6,129,500)	92,511	7,770,889	7 vite	91,300	7,800,873	7 vite e 1 muaj	
6000-15000	122	(14,030,000)	211,750	17,787,025	7 vite	273,900	16,715,643	5 vite e 1 muaj	
20000-40000	325	(23,172,500)	349,735	29,377,751	7 vite	730,400	25,699,102	2 vite e 11 muaj	
50000+	406	(28,947,800)	436,900	36,699,590	7 vite	2,334,000	30,135,943	1 vit e 1 muaj	

SHKODER	Fashat e energjisë (kwh/vit)	Fuqia e instaluar	Investimi	SKENARI 1 - Afat shlyerje për 7 vite			SKENARI 2 - sipas faturës së energjisë		
				Kësti	Pagesa e plotë	Vitet e shlyerjes	Kësti	Pagesa e plotë	Vitet e shlyerjes
				0-1000	9	(1,552,500)	23,431	1,968,236	7 vite
2000-5000	45	(6,727,500)	101,536	8,529,024	7 vite	91,300	8,819,001	8 vite e 1 muaj	
6000-15000	134	(15,410,000)	232,578	19,536,569	7 vite	273,900	18,731,995	5 vite e 8 muaj	
20000-40000	358	(25,525,400)	385,247	32,360,722	7 vite	730,400	28,628,654	3 vite e 3 muaj	
50000+	447	(31,871,100)	481,020	40,405,706	7 vite	2,334,000	33,308,929	1 vit e 2 muaj	

FIER	Fashat e energjisë (kwh/vit)	Fuqia e instaluar	Investimi	SKENARI 1 - Afat shlyerje për 7 vite			SKENARI 2 - sipas faturës së energjisë		
				Kësti	Pagesa e plotë	Vitet e shlyerjes	Kësti	Pagesa e plotë	Vitet e shlyerjes
				0-1000	9	(1,380,000)	20,828	1,749,543	7 vite
2000-5000	38	(5,681,000)	85,742	7,202,287	7 vite	91,300	7,078,399	6 vite e 6 muaj	
6000-15000	113	(12,995,000)	196,129	16,474,868	7 vite	273,900	15,258,090	4 vite e 8 muaj	
20000-40000	303	(21,603,900)	326,061	27,389,103	7 vite	730,400	23,783,360	2 vite e 9 muaj	
50000+	378	(26,951,400)	406,769	27,389,103	7 vite	2,334,000	27,983,354	1 vit	

**Tabela 2.**

Nr	Qarku	Intervali	kwh/vit	kwp	Llogaritja	Konsumatori
1	TIRANE	0-1000	12000	8	12000	konsumator familjar 11.4-50.4
		2000-5000	60000	41	53300	konsumator TU 0.4 kV - 16.8
		6000-15000	180000	122	122000	konsumator TU 0.4 kV - 16.8
		20000-40000	480000	325	201500	konsumator TU, Matje TM - 14.88
		50000+	600000	406	251720	konsumator TM - 22.56
2	DURRES	0-1000	12000	8	12000	konsumator familjar 11.4-50.4
		2000-5000	60000	41	53300	konsumator TU 0.4 kV - 16.8
		6000-15000	180000	123	123000	konsumator TU 0.4 kV - 16.8
		20000-40000	480000	329	203980	konsumator TU, Matje TM - 14.88
		50000+	600000	412	255440	konsumator TM - 22.56
3	BERAT	0-1000	12000	8	12000	konsumator familjar 11.4-50.4
		2000-5000	60000	42	54600	konsumator TU 0.4 kV - 16.8
		6000-15000	180000	125	125000	konsumator TU 0.4 kV - 16.8
		20000-40000	480000	333	206460	konsumator TU, Matje TM - 14.88
		50000+	600000	417	257920	konsumator TM - 22.56
4	ELBASAN	0-1000	12000	8	12000	konsumator familjar 11.4-50.4
		2000-5000	60000	41	53300	konsumator TU 0.4 kV - 16.8
		6000-15000	180000	122	12200	konsumator TU 0.4 kV - 16.8
		20000-40000	480000	326	202120	konsumator TU, Matje TM - 14.88
		50000+	600000	408	252960	konsumator TM - 22.56
5	KORCE	0-1000	12000	8	12000	konsumator familjar 11.4-50.4
		2000-5000	60000	40	52000	konsumator TU 0.4 kV - 16.8
		6000-15000	180000	119	119000	konsumator TU 0.4 kV - 16.8
		20000-40000	480000	318	197160	konsumator TU, Matje TM - 14.88
		50000+	600000	397	246140	konsumator TM - 22.56
6	LEZHE	0-1000	12000	8	12000	konsumator familjar 11.4-50.4
		2000-5000	60000	40	52000	konsumator TU 0.4 kV - 16.8
		6000-15000	180000	119	119000	konsumator TU 0.4 kV - 16.8
		20000-40000	480000	318	197160	konsumator TU, Matje TM - 14.88
		50000+	600000	397	246140	konsumator TM - 22.56
7	SHKODER	0-1000	12000	9	13500	konsumator familjar 11.4-50.4
		2000-5000	60000	45	58500	konsumator TU 0.4 kV - 16.8
		6000-15000	180000	134	134000	konsumator TU 0.4 kV - 16.8
		20000-40000	480000	358	221960	konsumator TU, Matje TM - 14.88
		50000+	600000	447	277140	konsumator TM - 22.56
8	VLORE	0-1000	12000	8	12000	konsumator familjar 11.4-50.4
		2000-5000	60000	41	53300	konsumator TU 0.4 kV - 16.8
		6000-15000	180000	122	122000	konsumator TU 0.4 kV - 16.8
		20000-40000	480000	325	201500	konsumator TU, Matje TM - 14.88
		50000+	600000	406	251720	konsumator TM - 22.56
9	FIER	0-1000	12000	8	12000	konsumator familjar 11.4-50.4
		2000-5000	60000	38	49400	konsumator TU 0.4 kV - 16.8
		6000-15000	180000	113	113000	konsumator TU 0.4 kV - 16.8
		20000-40000	480000	303	187860	konsumator TU, Matje TM - 14.88
		50000+	600000	378	234360	konsumator TM - 22.56



Albania  
Investment  
Council

Improving Transparency and Investment Climate

## RRETH KËSHILLIT TË INVESTIMEVE NË SHQIPËRI

Këshilli i Investimeve ka si qëllim rritjen e besimit të ndërsjellë midis biznesit dhe qeverisë duke kontribuar në institucionalizimin e dialogut mbi politikat në vend. Kontribuon në reformat kombëtare dhe procesin e tranzicionit ekonomik duke ndihmuar në përmirësimin e institucioneve, ligjeve dhe politikave që promovojnë mirëfunksionimin e tregut.

**Dr. Diana Leka (Angoni)**

Drejtoare e Sekretariatit  
lekad@investment.com.al

**Elvis Zerva**

Ekspert Ligjor dhe Rregullator  
zervae@investment.com.al

**Elida Fara**

Eksperte Ekonomie  
farae@investment.com.al

**Xaira Shurdha**


Eksperte për Monitorimin dhe Bashkëpunimin  
shurdhax@investment.com.al

**Elisa Lula**

Oficere Administrative dhe Komunikimi  
lulae@investment.com.al

Publikuar nga Sekretariati i Këshillit të Investimeve (SKI), Dëshmorët e Kombit, Tiranë, Shqipëri  
info@investment.com.al / www.investment.com.al / SKI është përgjegjës për përmbajtjen e këtij publikimi.

Albania Investment Council ALInvestCouncil Albania Investment Council



Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO

Këshilli i Investimeve mbështetet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, BERZH dhe Sekretariati Shtetëror Zvicerian për Çështje Ekonomike (SECO).